

Procesverbal

*Nga Mbledhja III (e tretë) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Dragashit, e mbajtur më datë:
08.04.2025*

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Propozim-vendim për ndarjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2024 në vitin 2025;
3. Propozim-vendim për rialokimin e mjeteve të Buxhetit për vitin 2025;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për shpalljen e Listës së Përgjithshme dhe të Veçantë të pronës së paluajtshme të Komunës për vitin 2025;
5. Propozim-vendim për emërimin e Komisionit për Përzgjedhjen e Drejtorëve në Institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Dragashit;
6. Propozim-vendim për anulimin e vendimeve për shpalljen e interesit publik: 01Nr. 060/01-3240-1/25 i datës 28.02.2025; 01Nr. 060/01-3240-2/25 i datës 28.02.2025; 01Nr. 060/01-3240-3/25 i datës 28.02.2025; 01Nr. 060/01-3240-4/25 i datës 28.02.2025; 01Nr. 060/01-3240-5/25 i datës 28.02.2025;
7. Shqyrtimi i Kërkesës për shprehje të interesit për marrje në shfrytëzim afatgjatë të tokës për ndërtimin e fabrikës për shkrirjen dhe përpunimin e xeheve "Ferrokrom Kosova", ZK Shajne P-70604038-00244-5;
8. Përgjigjet e ekzekutivit për pyetjet e parashtruara nga asambleistët nga seanca e dytë; dhe
9. Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshendetje kryetar, kolegë asambleistë, OSBE, media dhe ju të pranishëm! Mirë se erdhët në seancën e tretë të rregullt për vitin 2025! Materialin besoj se e keni pranuar të gjithë. Në këtë seancë kemi tetë pika të rendit të ditës dhe pikën eventuale, siç e keni pranuar në ftesë. Mirëpo, pika e shtatë e rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së Ferrokromit, unë si kryesuese e Kuvendit dhe kryetari i Komunës, të cilët jemi edhe propozues të kësaj pike, kemi vendosur që ta heqim këtë pikë nga rendi i ditës, pasi që kemi pasur të dielën një takim me banorët e fshatit Shajne, si dhe kemi pranuar një peticion nga këta banorë që të hiqet nga rendi i ditës kjo pikë dhe të mos diskutohet fare për këtë pikë nga Asambleja e Komunës. Andaj, unë si kryesuese e Kuvendit dhe kryetari i Komunës në asnjë mënyrë nuk jemi kundër vullnetit të banorëve të fshatit Shajne dhe kundër vullnetit të asnjë banori të Komunës sonë. Para se të votohet rendi i ditës, fjalën do t'ia kalojë për një sqarim kryetarit të Komunës.

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese, i nderuar zv/kryesues, të nderuar asambleistë, mjete të informimit, i nderuar përfaqësues i OSBE-së dhe ju të pranishëm të tjerë. Të nderuar qytetarë! Unë nuk kam çka shtoj më tepër, përveç fjalëve që i lexoi kryesuesja. Unë si kryetar i Komunës dhe kryesuesja e Kuvendit, si propozuese dhe hartuese e rendit të ditës për Asamblenë Komunale, ne jemi pajtuar që kjo pikë e rendit të ditës të hiqet nga shqyrtimi në seancën e tretë të Asamblesë Komunale. Gjithashtu, është vendimi që për këtë pikë fare mos të diskutohet, dhe ne si propozues do ta heqim nga rendi i ditës këtë pikë. Arsyeja ishte sepse ne të dielën kemi pas një takim me banorët e fshatit Shajne. Në këtë takim, ku kanë marrë pjesë afër 200 pjesëmarrës, të gjithë unanimisht kanë qenë që të mos fillojnë procedurat për ndërtimin e kësaj fabrike. Kështu që, unë dhe kryesuesja jemi pajtuar dhe e kemi dhënë fjalën para tyre që, para fillimit të seancës do ta heqim këtë pikë nga rendi i ditës dhe për këtë pikë nuk do të diskutohet fare. Unë nuk kam nevojë më shumë me dhënë sqarime për këtë çështje, ne kemi dhënë sqarime të bollshme në materialin që e keni marrë ju për këtë pikë të rendit të ditës. Gjithashtu, ka pas edhe sqarime të mjaftueshme edhe në rrjetet sociale, kështu që nuk po dua me ju humb kohë më shumë. Unë propozoj që kryesuesja ta heqë nga rendi i ditës këtë pikë. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Ashtu siç e tha edhe kryetari, unë edhe kryetari kemi të drejtë ligjore që pa e qit në Kuvend kjo pikë të largohet. A dëshiron dikush ta marrë fjalën rreth rendit të ditës?

Suada Bajrami: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryetar i Komunës, kryesuese e Kuvendit, kolegë asambleistë, media dhe të gjithë ju të pranishëm! Unë deshta të flas për pikën e shtatë. Pas takimit që është mbajtur të dielën me banorët e fshatit Shajne – të cilët i falënderoj shumë për një tubim të madh dhe për qetësinë e durimin, për edukatën dhe kulturën e treguar nga banorët atë ditë – me disponimin e të gjithë banorëve të fshatit Shajne, në emër të PDK-së, Dega në Dragash, bëjmë kërkesën që të largohet kjo pikë dhe të votohet nga Kuvendi për një plotfuqishmëri më të madhe. Faleminderit!

Shpetim Hajredini: Përshëndetje të nderuar kolegë/e asambleistë/e, ekzekutiv, qytetarë të nderuar të Dragashit, ju përshëndes të gjithëve! Ne si Grup i PDK-së, ju besoj që keni pas informacione që kena qenë kundër qysh nga dërgimi i materialit dhe caktimi i pikës në rendin e ditës të kërkesës së këtij investitori. Por, tani morëm edhe një informacion nga ana juaj, e nderuar kryesuese dhe i nderuar ekzekutiv, që doni ta largoni si pikë të rendit të ditës, pa votim. Kisha pas dëshirë unë së pari me dalë para qytetarëve dhe para asambleistëve ju, me na tregue qat ligj, qat nen që ju lejon juve ta largoni pikën e rendit të ditës pa votim. Kur, ne në material e kena si pikë të rendit të ditës

dhe ne vendosim tani a e largojmë apo jo. Nuk dua shumë të hyj në detaje dhe të diskutoj tash për këtë çështje dhe problematikë që ju e sollët para qytetarëve të Dragashit në përgjithësi, e në veçanti të atyre të Shajnes. Por, fillimisht dua që ju të na sjellni nenin, ligjin që ju jep të drejtë juve që pikën e rendit të ditës ta largoni pa votim, dhe pastaj diskutimin natyrisht që do ta vazhdoj prapë.

Munir Jonuzi: Përshëndetje të gjithëve. Do të doja t'i lutesha të gjithë delegatëve që të mos e politizojmë këtë çështje dhe të marrim vendime ashtu siç është në interes të qytetarëve tanë, sepse të gjithë ne jemi përfaqësuesit e tyre. Kryetari dhe kolegja kanë propozuar që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës, e di që ky propozim është i arsyeshëm dhe bazohet në një petition, në takimin që keni pasur me banorët e fshatit Sajnoc që kanë shprehur mendimin e tyre. Dua të rikujtoj ngjarjet që kanë ndodhur në këtë kuvend në vitin 2022. Atëherë kemi themeluar një komision që kishte për detyrë të verifikojë dhe rishqyrtojë të gjitha faktet pse një kërkesë nuk ishte përfshirë në rendin e ditës të kuvendit. Edhe pse ajo kërkesë kishte të bënte me ndërtimin e një hidrocentrali të ri. Vendimi i atëhershëm është ende në fuqi, ne krijuam komisionin për të parë nëse qytetarit i ishin shkelur të drejtat. Që ndonjë kuvend tjetër ose ndonjë delegat të mos rishqyrtojë veprimet tona dhe vendimet tona, propozoj që kjo pikë të qëndrojë në rendin e ditës dhe secili delegat të votojë ashtu siç mendon. Të përfaqësojmë vullnetin e popullit. Nëse banorët e fshatit Sajnoc nuk duan që të ndërtojmë këtë fabrikë, unë do të jem kundër dhe do të votoj kundër. Por dua që të respektohet kjo procedurë. Ka qenë në rendin e ditës dhe kemi votuar kundër.

Nedžmidin Sejdilar: Përshëndetje të gjithëve. E dëgjuam se keni dëshirë ta hiqni këtë pikë nga rendi i ditës, dhe unë pajtohem plotësisht me atë që tha kolegu Jonuzi. Ju e keni lehtë. E shihni që jemi të gjithë kundër ndërtimit të kësaj fabrike. Pse e merrni barrën mbi shpatullat tuaja, ju kryetar dhe kryesuese e kuvendit, që vetë ta hiqni këtë pikë kur mundemi gjatë diskutimit ta rrëzojmë propozimin dhe t'i mbyllim derën kësaj investimi. Kështu po i hapim derën që e njëjta kërkesë të vijë përsëri. Nëse them se dyshoj që doni të ndihmoni Sajnocin, kam plotësisht të drejtë – mënyra më e mirë është që pika të mbetet në rendin e ditës dhe ta rrëzojmë kur të shqyrtohet. Nuk ka nevojë ta heqim. Nëse ju e hiqni vetë nga rendi i ditës, duhet të na dërgoni një rend të ri të ditës dhe të shtyni seancën. Ne nuk jemi të njoftuar që pika është hequr në mënyrë të njëanshme. Pikën mund ta heqë vetëm kuvendi me votim. Kjo mënyrë që doni ju, i hap derën që i njëjti propozim të kthehet pas disa muajsh dhe qytetarët të jenë sërish në të njëjtin problem. E gjithë opozita është kundër kësaj pike. Ju jepni vetëm dy vota dhe kaq. Kjo është një investim i dëmshëm. Në material nuk kam lexuar askund për dëmet që përmenden, që do të thotë se ato fshihen. Ta lëmë pikën, ta

shqyrtojmë dhe ta rrëzojmë – kjo është më e mira për të gjithë. Jam i kënaqur që jeni takuar me banorët e Sajnocit, por kur morët lumin në Radesh, a jeni takuar me ata njerëz? A keni bërë një diskutim të tillë në Radesh? Ku është ajo peticioni famoz që na përmendni dy vite me radhë, por nuk e keni treguar në kuvend?

Nexhat Selaj: Faleminderit kryesuese, faleminderit media, përshëndetje për ju asambleistë! Derisa nuk e kam pranuar këtë material, kam pas pak një bindje dhe një qasje tjetër te ky investim, por me pranimin e këtij materiali diçka është ndryshue pak. Po më duket se në mënyrë të turbullt, me një shpejtësi na u afrue, edhe po më duket se në mënyrë të turbullt po duhet me iu lidhë koka kësaj pune. Unë po besoj dhe po shpresoj, edhe nga kolegët asambleistë, se do të ishte më e plotfuqishme që kjo pikë të mbetet si pikë e rendit të ditës, dhe të votohet nga asambleistët, që një herë e përgjithmonë të marrë fund ky problem, pasi që dy javë ne po e dimë – jo vetëm banorët e lokalitetit të fshatit Shajne, por në një ankh kanë qenë edhe banorët e qytezës së Dragashit, po ashtu edhe të Pllavës, e ma shumë të Rapçës. Unë e kuptoj se kur të votohet në Kuvend e ka një bazë ligjore. Kjo nuk është afatgjate, që pas një kohe të vjen prapë në seancë. Kështu që, dalja në votim, pro ose kundër nga asambleistët, do të ishte më e plotfuqishme. Faleminderit!

Uran Halimi: Përshëndetje të nderuar delegatë! Faleminderit, znj.kryesuese, për fjalën, përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm dhe ju qytetarë të Sharrit! Po më vjen mirë që sot po diskutojmë për pikën e shtatë, edhe pse ende nuk i ka ardhë radha asaj pikës që të diskutojmë. Ne si LVV kemi qëndrue me qytetarët e Shajnes edhe të gjithë Dragashit, pa dallim, prej fillimit kur është hapur si çështje dhe është kërkuar që të diskutohet në lidhje me pikën e shtatë, që ka të bëjë me ndërtimin e kësaj fabrikës ose shkrites së ferrokromit. Mirëpo, ajo çka due me shtue, edhe pse nuk dua të diskutoj në lidhje me atë pikë, është që ne duhet të ndjekim rrugën ligjore, edhe propozimi i juaj, znj.kryesuese, edhe i kryetarit, duhet të mbetet si propozim që, në momentin që ne mbërrijmë te pika e shtatë, të votojmë si delegatë për largimin e asaj pike, edhe pse ka qenë kërkesë e qytetarëve, ne s’jemi kundër kërkesës së qytetarëve. Mirëpo, mendoj që duhet t’i ndjekim hapat ligjorë, rrugën ligjore e cila është që, në momentin që ne arrijmë në pikën e shtatë, votojmë për largimin e pikës së shtatë. Nuk mendoj që është e udhës, ligjore apo e demokracisë, largimi i kësaj pike të rendit të ditës me propozim, pa e votuar fare. Sidoqoftë, ne e mbështesim mendimin e qytetarëve të fshatit Shajne, edhe propozoj që propozimi i kryetarit edhe i juaji të mbetet si propozim, edhe pika e shtatë të largohet apo të qëndrojë në rend të ditës, varet prej disponimit të delegatëve. Domethënë, duhet të votohet ajo së pari. Faleminderit shumë!

Jetmir Ajdini: Përshëndetje për të gjithë! Po më vjen mirë që reagimi ynë si LVV, ju ka nxit edhe juve si qeverisje komunale që të shkoni t'i takoni edhe të ballafaqoheni me shqetësimin e qytetarëve të fshatit Shajne, për mosndërtimin e kësaj fabrike aq të dëmshme për shëndetin e tyre dhe aq të dëmshëm për ambientin e Komunës tonë. Po më vjen mirë që e keni marrë atë vullnet, keni shkue i keni takue qytetarët edhe e keni parë përgjigjen e tyre që janë kundër ndërtimit të një fabrike të tillë në Komunën tonë. Xehet të nxirren në veri, e të vijnë të shkrihen në Komunën e Dragashit, edhe dëmin ta paguajnë qytetarët e fshtrave përreth, shumë e padrejtë. Atëherë, po na vjen mirë që kjo pikë duhet të largohet, por unë mendoj që duhet të largohet me votim të Asamblesë Komunale, edhe t'i qitet pika një herë e përgjithmonë që mos të diskutohet për këto çështje. Domethënë, reagim i mirë i LVV-së, që është ballafaque me atë shqetësim të qytetarëve të fshatit Shajne, edhe juve ju ka nxit si qeverisje komunale që të shkoni t'i takoni, se po besoj s'i keni takue moti qytetarët e fshatit Shajne, edhe jeni ballafaque me përgjigjen e tyre. Faleminderit!

Artan Loshaj: Përshëndetje për të gjithë! Edhe unë si shumica e kolegëve asambleistë, jam kundër kësaj fabrike që të ndërtohet, jam në anën e qytetarëve të fshatit Shajne dhe në anën e të gjithë qytetarëve. Edhe dje kam pas një ballafaqim me kryetarin dhe kryesuesen, se këta po dojnë të jenë shpëtimtarët e kësaj çështjeje. Ndërsa është e kundërta, ju jeni ata që e keni sjellë në rend dite edhe e keni sjellë këtë shqetësim te qytetarët e fshatit Shajne. Ju, po të ishit në anën e tyre, ishte dasht që në fillim të hapet diskutim publik këtu, të diskutohet me qytetarët, të diskutohet me Asamblenë, dhe t'i shterrim krejta mendimet dhe qëndrimet këtu, e pastaj të qitet në rend dite. Ju, kur e keni pa reagimin e qytetarëve të fshatit Shajne, të cilët janë të gjithë bashkë, unikë, kundër kësaj, atëherë e keni marrë mundin edhe i keni lut që të shkoni në fshatin Shajne, të bëni një dëgjim të qytetarëve. E keni marrë përgjigjen e tyre, pastaj e keni ndërrue lëkurën, nga lëkura e ujkut në lëkurë të qengjit, që po bëheni ju shumë të mirë, ju jeni shpëtimtarët. Jo, është e kundërta, e keni gabim. Edhe, keni shkruar nëpër rrjete sociale fjalë miradie, se ata janë shumë mikpritës, janë shumë zemërgjerë, janë shumë bashkë, janë shumë unikë. Po, është e vërtetë, gjithmonë fshati Shajne kanë qenë bashkë, kur është dashtë me qenë bashkë, kanë qenë bashkë edhe kohë të vështira, janë bashkë edhe në kohën e tashme. Atëherë, unë kërkoj nga ju që kjo pikë të qitet në rend dite për me u largue, por të largohet me vendim të Kuvendit Komunal, jo me vendim të kryetarit dhe të kryesueses, se kjo nuk është e mirë. Kurrë nuk ka qenë kjo, edhe na tregoni ligjin, nenin edhe rregulloren ku jeni bazuar ju të dy që po doni me e largue. Tash neve na qitni para aktit të kryer. Edhe një herë thashë, ne jemi që të largohet, fshati Shajne gjithmonë ka qenë për të mirën e qytetarëve, e kanë dhënë Parkun

e Biznesit, e kanë dhënë vendin e shkollës, nuk kanë kundërshtue kurrë dhe nuk kundërshtojnë kurrë. Por, kur është në pyetje shëndeti i qytetarëve, ata gjithmonë do t'jua tregojnë vendin ku e keni. Faleminderit!

Agron Gashi: Ju përshëndes, të pranishëm! Përshëndetje kryetar, kryesuese dhe të gjithë kolegë të tjerë! Unë paksa në kundërshtim me të gjitha idetë deri më tash që ishin, ngase qëndrimet e mia do të ishin paksa më ndryshe. Na është kërkuar lokacioni se ku duhet të ndërtohet ajo fabrikë, dhe ne si Asamble Komunale dhe qytetarë nuk jemi ata ekspertë të kësaj lëmie, të cilët mund të marrim vendime, mirë apo keq. Vendlokacioni është kërkuar, ndoshta nuk do të ishte edhe keq me dalë pozitivisht, me e kaluar këtë pikë. Mirëpo, sipas disa të dhënave, duhet të kalojnë edhe dhjetë procedura tjera ligjore nga ministritë dhe dikasteret e nivelit qendror, dhe ata të japin pëlqimin se a është e mirë apo e keqe, a është e dëmshme apo është shkatërruese për mjedis. Dhe janë ekspertët të cilët duhet të merren me atë, e jo vetëm kundërshtime, sepse kjo Komunë nuk mund të zhvillohet vetëm duke kundërshtuar. Unë kam të afërm, familjarë të cilët punojnë midis Sllovenisë, 10 minuta afër e ka vendlokacionin, shkritoren e metaleve në brendi të qytetit. Dhe, sipas disa përshkrimeve, thuhet se është një fabrikë e vitit 2024 e cila edhe oxhaqe nuk do të ketë. Do të ketë një standard të avancuar lidhur me shkritoren dhe përpunimin e metaleve. Andaj, është dashur ndoshta t'i jepet drejta ekspertëve të nivelit qendror, e jo vetëm të marrim vendime, nuk bën edhe pikë. Sepse, ky vend nuk mund të zhvillohet vetëm me kundërshtime. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Pa dashur të përziehem në punën e Kuvendit – është çështje e Kuvendit se çfarë vendimi do të marrë – mirëpo, unë dola këtu sepse një prej asambleistëve tha pse nuk ke shkue në Radeshë me mbajt takim, të cilët kanë bo petition për moslejimin e marrjes së ujit nga lumi “Radesha”. I njëjti delegat çdo herë është i padisiplinuar dhe çdo herë del jashtë rendit të ditës edhe i diskuton dhe propozon çështje shumë pa vend, edhe të cilat nuk janë në rend të ditës. Por, unë dua t'i them atij se unë në atë kohë, kur është dhënë pëlqimi nga qytetarët e fshatit Radeshë për marrjen e ujit për projektin kryesor për 15 fshatra dhe qytezës së Dragashit, unë nuk kam qenë atëherë kryetar i Komunës. Tash jam kryetar i Komunës, më kanë thirrë qytetarët e fshatit Shajne, kam marrë pjesë në takim, ata kanë kërkuar që të hiqet nga rendi i ditës kjo pikë, edhe unë me kryesuesen kemi pranuar që ta heqim këtë pikë nga rendi i ditës, si propozues të rendit të ditës. Sa i përket Radeshës, në Komunë ekziston marrëveshja në mes të ish-kryetarit të Komunës së Dragashit edhe qytetarëve të Radeshës, që ata kanë lejue që uji i lumit “Radesha” të merret për shfrytëzim për projektin kryesor. Prandaj, nuk është mirë me dalë këtu me bo propagandë, se ti je

mësue me dalë me bo propaganda edhe me e gënjye opinion publik, sepse ti e ke vetëm një qëllim, me shti përçarje në mes të komunitetit shumicë dhe joshumicë, me i prish ato urat shumë të mira që i kemi ndërtue, jo vetëm unë por edhe qeveria e kaluar, në mes të komuniteteve që jetojnë në Dragash. Ty kjo nuk të konvenon, ti dëshiron që çdoherë të ketë këtu ndasi, por këtë nuk do të mund ta arrish kurrë. Unë propozoj – masi ka dy propozime: propozimi i kryetarit dhe kryesueses që të hiqet nga rendi i ditës, edhe propozimi që me votim të hiqet, i propozoj kryesueses që ta bëjmë një pauzë 5 minuta, të merremi vesh edhe e vazhdojmë.

Samidin Xheladini: Të nderuar të pranishëm, ju përsëndes të gjithëve! Po më vjen shumë mirë që po bëhet debat, po duhet të bëhet debat konstruktiv. Ne jemi njerëz të zgjedhur të popullit dhe nuk duhet me anue, vetëm pse mendon qashtu, po duhet me i kqyr gjërat hollë e gjatë. Kryesuesja me kryetarin kanë qenë në fshatin Shajne, unë sa e pashë disa herë u përmend, edhe e kemi parë edhe në mjete të informimit, që kanë kërkue me u hek prej rendit të ditës banorët e fshatit Shajne, që kanë qenë edhe prezentë disa aty të PDK-së, edhe të VV-së, kanë kërkue që me u hek prej rendit të ditës. E qashtu duhet me e bo, banorët e fshatit Shajne kanë thënë me e hek prej rendit të ditës edhe na, kryesuesja edhe kryetari, me e hek prej rendit të ditës. E jo për tekat e dikujt këtu me dalë me bo propagandë, për qëllime personale këtu me u avancue, se na jemi për Shajne e këta tjerët janë kundër Shajnes, e kundër popullit. Kuvendi është për me pru vendime. Sa herë e keni hek prej rendit të ditës ju PDK-ja, pa hy në debat? E keni bo shumë herë. Pse po bëheni tash dyfytërështa? Nuk është problem, edhe ashtu e bëjmë, se na e kemi vendos me e hek, se kanë thënë këta të dy kryesorët që me e hek. Edhe baorët e fshatit kanë thënë me e hek, e hekim. Po ju, çka po doni me përfitue me këtë mesele? Keni mbarue, janë krye meselet!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Unë nuk do të marr pauzë, për arsye se krejt vullneti i asambleistëve ishte po i njëjti, që kjo pikë të largohet. Atëherë, para se me e qit propozimin e Suadës, që ka ardhë edhe nga Grupi juaj – me sa e dëgjova – deshta të them se unë dhe kryetari kurrë nuk e kemi pas lëkurën e ujkut. Ndoshta të deles po, veç të ujkut kurrë. Për ndonjë individ që vetë është ujk, kjo është e rëndë. Jam bullizuar dje dhe jam lënduar shumë, po nga i njëjti. Unë në Facebook-un tim, a shkruaj fjalë miradie a çfarë shkruaj, është e drejtë e imja e padiskutueshme, jo që nuk më përzihet dikush këtu, por as në familje s'e lejoj. Fjalët miradie i kam thënë, se fshati Shajne na ka prit ngrohtësisht dhe na ka prit aq mirë, sa unë hala në asnjë fshat nuk jam prit si aty. Para se me e qit në votim, ju kisha lut që të gjithë t'i ngrini duart më lart! Suada ka propozue që kjo pikë të largohet nga rendi i ditës. Kush është që të largohet kjo pikë? A ka kundër? A ka abstenim? Me

24 vota pro, 2 kundër dhe zero abstenim, kjo pikë largohet nga rendi i ditës. Atëherë, kush është pro rendit të ditës, pa pikën e shtatë? A ka kundër? Abstenim? Me 23 vota pro, 1 kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë rendin e ditës pa pikën e shtatë. Atëherë, fillojmë me pikën e parë: Miratimi i proceverbalit nga mbledhja e kaluar. A do dikush me e marrë fjalën rreth pikës së parë? Nëse jo, e hedhim në votim. Kush është pro miratimit të procesverbalit? A ka kundër? Abstenim? Me 24 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë pikën e parë. Vazhdojmë te pika e dytë: Propzim-vendim për ndarjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2024 në vitin 2025.

Munir Jonuzi: Fjalimi im i sotëm do të bazohet në informacionet që kam arritur të mbledh. Nëse gabo, kërkoj falje paraprakisht, por kjo është për shkak të mungesës së informacionit. Dje në KPF kam drejtuar disa kërkesa drejtorit të financave. Kam kërkuar informacion, nuk i kam marrë. Nga shuma e fondeve të pashpenzuara arrijmë në përfundimin se kemi më pak mjete në dispozicion. Jam 8 vjet delegat dhe kurrë nuk kemi pasur kaq pak mjete. E kuptoj pushtetin ekzekutiv sepse duhet të respektojmë kontratat kolektive në arsim dhe shëndetësi. Lista e investimeve kapitale dhe shpenzimi prej 87.000 euro, mund ta përgëzoj pushtetin ekzekutiv që na ka shpjeguar pse këto projekte janë përfshirë në këto mjete. Kjo është mirë për transparencën. Ajo që mungon është që tregon sa pak rëndësi ka pozita e delegatit. Thjesht, në këtë kuvend nuk përfaqësojmë popullin, premtimet apo bisedat, por jemi pionerë të pushtetit ekzekutiv që duhet të votojmë çdo vendim, të mbulojmë çdo gabim të tyre dhe të nëpunësve. Do të ndalem vetëm te dy projektet që janë në Gorë: kalldrëmimi në Krushevë dhe ujësjellësi në Kukuljanë. Në vendim thuhet se ekzekutori ka marrë disa mjete. Nëse ka marrë mjete, pse atëherë në raportin e drejtorit të Urbanizmit kemi marrë informacion që këto projekte janë përfunduar? Kështu qëndron në raport. Nuk janë realizuar vetëm Zlipotoku dhe Radesha. Si tani nuk janë? Kjo më bën të mendoj që nuk i shikojnë, nuk i lexojnë por i manipulojnë dhe na sjellin informacione të pasakta. Nëse shikojmë nga janë marrë mjetet, Zlipotok, Krushevë, Kukuljanë – këto informacione kemi. Të gjithë po e shikoni që modeli nuk është i saktë. Më intereson kush janë ata ekzekutorë? Si e dinë që të marrin mjete nga Gora? Kjo vetëm tregon çfarë përfaqësuesish kemi nga komuniteti joshumicë në pushtetin ekzekutiv. Renovimi i GCPM-së rreth 17.000 euro në muajin prill, kontrata është nënshkruar në nëntor. Drejtori i urbanizmit dhe shëndetësisë presin fundin e vitit për të realizuar ndonjë projekt. Ndodhi që këto mjete na humbën. Tani duhet t'i futim në të ardhurat vetanake. Nëse shikojmë strukturën dhe kërkesat për këto 17.000 euro, shohim se struktura nuk është ndryshuar. Nëse asnjë firmë nuk ishte e interesuar atëherë, pse dikush do të jetë i interesuar sot kur e dimë që çmimet po rriten? Kur

shikoj një shpërndarje të tillë të të ardhurave ku përqindja është 83% në Opole dhe 17% në Gorë, kjo jo vetëm që tregon se nuk e vlerësoni komunitetin joshumicë, por që nuk e respektoni as ligjin, as ndarjen e drejtë dhe i injoroni nevojat e komunitetit joshumicë. Deri në vitin 2023 përqindjet ishin respektuar. Vitin e kaluar raporti ishte 65% me 35%. Kjo është hera e dytë që po injoroni obligimet tuaja. Ka kaq shumë drejtorë, pozita në pushtetin ekzekutiv dhe një sjellje të tillë ndaj komunitetit joshumicë, kjo më bën të mendoj vetëm një gjë: A nuk e shihni që më të këqinj të ndër ne, më të korruptuarit ndër ne po marrin vendimet më të rëndësishme? Janë njerëz që kanë më pak kredibilitet për të përfaqësuar komunitetin joshumicë. Udhëhiqen nga interesat personale, familja, disa vetura që nuk duhet t'i prekim, ndërsa me komunitetin bëni çfarë të doni. Mos na prekni interesat personale, ndërsa me komunitetin bëni çfarë të doni, dhe ne do të flasim se të drejtat e komunitetit janë respektuar. Ne do të japim raporte të manipuluar.

Qamil Kolloni: Përshëndetje për të gjithë! Po më vjen se jemi në vitin e fundit zgjedhor edhe po i shoh te Muniri dy fytyra të ndryshme brenda katër viteve. Unë po besoj se keni filluar dhe t'i harroni mbledhjet paraprake që po japim sqarime. Po delni po bëni demazhe politike dhe fjalime politike. Unë si drejtor jam i thirrur me ju dhënë përgjigje profesionale, por mos me m'ërtheq në përgjigje politike. Mirëpo, në qoftë se vazhdoni me këso ligjërata, do të jem i detyruar me ju dhënë edhe përgjigje politike. Po ju them me shumë sinqeritet se ju keni marrë raportin vjetor, ku buxheti i Komunës së Dragashit është ekzekutuar në shumën 96%. Është prej buxheteve që në tërë Kosovën është vlerësuar si më i sukseshëm dhe na garanton për Grantin e Performancës. Ne i kemi diskutuar që përmbaruesi ka marrë mjete të lira nga të gjitha pozicionet. Kemi thënë se ka marrë nga investimet kapitale, kemi projekte në të cilat na i ka zënë mjetet pa zotue, qoftë në territorin e Gorës, qoftë në territorin e Opojës. Me Shpetimin e kemi bisedue, që ka mbet pa ujë, a ti ke mbet pa do kocka edhe po ankohesh. Që ka dallim mos me pas ujë edhe mos me pas kocka. Dhe ky i takon komunitetit shumicë, e ti i takon komunitetit pakicë. Kurrë nuk të kemi vu në këso pozicione. Duhet ta dini se mbi 41% e buxhetit fair play i ndahet komunitetit dhe nënkryetarit, bashkë me delegatët edhe sektorin e ekzekutivit bëjnë ndarjet për komunitetin në Gorë, pa implikimin tonë. Pse e ka hup kredibilitetin Muniri edhe VAKAT-i, nuk është fajtor qeverisja lokale. Ne po ua japim paratë. Nga i tërë buxheti i Komunës së Dragashit, 4% janë hek mjete. Janë disa projekte të investimeve kapitale që i kompenzojmë këtë vit, projekte të cilat janë krye por përmbaruesi pa i zotue na i ka marrë paratë dhe e kemi obligim ndaj operatorëve që t'ua paguajmë sivjet. Janë shumë pak para. A e dini ju që për projektin kryesor të ujit ne kemi raportue që na janë marrë gjysmë

million euro. Dhe, ky është problemi ynë qysh kemi me e zgjidhë sivjet. Janë vendime të përbashkëta të juajat dhe tonat. Drejtori i Buxhetit nuk e bën as ujin, as investimet kapitale nuk e bën ndarjen, as nuk i lejon me e marrë asnjë pare, por ja që po i marrin. Ne kemi raportuar dhe nuk presim tash pse po i teket secilën seancë që të bëjë se po na merren neve, e po u jepen atyre. Munir, ku duash me na çue me këtë fjalor, ti? Na trego neve ku duash me na çue? Sa për shifra, 96% e buxhetit të Komunës së Dragashit për vitin 2024 është ekzekutue dhe realizue në plotni. Çka ka dokument më të fuqishëm se konstatimi i MAPL-së dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, të cilin buxhet e kemi realizue. A ka vlerësim më të madh se Ministria e Ekonomisë dhe Financave që Komuna e Dragashit hyn në komunat e dyta që pranon të gjitha kërkesat e qytetarëve. E ke në uebfaqe, dish me lexue dhe nxirre e lexoje! Është Komuna e Dragashit në mesin e katër komunave e cila ka ekzekutue për kokë banori – po jua citoj decidivisht, lexone mirë – për kokë banori në investime kapitale jemi komuna e katërt në Kosovë. Qaq është buxheti neve që na takon me na dhënë për investime kapitale, qaq banorë kemi. 6 milionë kemi, atë e mbërrimë me grante përmes Qeverisë edhe me projekte që i marrim prej Qeverisë. 4 milionë e 800 mijë janë investime të Grantit të Përgjithshëm. Prandaj, nuk ka kurrfarë diskriminimi. Përkundrazi, në qoftë se kahmos kemi gabue, mund të na jepni vërejtje, nuk janë krye punimet diku, operatorët kanë ngec, kemi pas lëshime. Veç sa i përket sektorit të Financave – gjithkund mund të bëni vërejtje, ama bash gjithkund – por këtu, të jeni të bindur se cent më cent i keni të harmonizuara me pasqyrat vjetore. Në qoftë se në përgjithësi e bëjmë rekapitulimin e Buxhetit, kqyre ti se sa % është ekzekutue Buxheti i Komunës së Dragashit. Unë nuk di deri më tash që ka pas Komunë e Dragashit qeverisje në aspektin ekonomik më të mirë se qeverisja e Bexhet Xheladinit. Ti mundesh me m'shit mu mend sa të duesh, ti mundesh me majt fjalime sa të duash, ti mundesh me m'folë mu për Restelicë e për Billushë e për çka të duash, por një send: numrat nuk lejojnë me rre. Pasqyrat nuk lejojnë me rre. Munir, ti mundesh me bo politikë, por bën në rrethana tjera, në mënyrën tjetër. Të lutem, qato paret e komunitetit goran, është në pyetje vetëm ti pse s'pyetesh. Po nuk pyetesh, o Munir, se kështu në qoftë se rrejsh, ti e ke hup edhe te komuniteti legjitimitetin, e ke me e hup edhe këtu legjitimitetin. Ne nuk mundim me të ndryshue ty, se ti po ndryshoh vetë. Për katër vjet këtu, sa të kam pas në koalicion, kam qenë i mirë, dhe sot nuk po dikam me i no pasqyrat. Çka po duash me të bo, a po duash me të vizatue. Edhe mos i ik realitetit, mos u mundo me i baltos njerëzit pa nevojë.

Munir Jonuzi: Natyrisht që unë do të kem qëndrime politike këtu sepse kjo është një pozitë politike. Unë jam politikan i përgjegjshëm dhe do të flas vetëm me argumente. A e keni vërejtur që drejtori i financave nuk më është përgjegjës në asnjë pyetje? Nuk dha asnjë argument. Unë po flas këtu për ndarjen e mjeteve financiare mes komunitetit shumicë dhe atij joshumicë, ndërsa ju më flisni për sukseset tuaja në financa. Kjo është në rregull, por sa është përqindja? Të gjithë ju keni listën e investimeve kapitale. 57.000 në Opole, 11.000 në Gorë dhe 20.000 mjete të përbashkëta – ky është raporti juaj. Mohoni këtë nëse mundeni. Kur Vakati ishte faktor dhe i bashkuar në këtë komunë, kurrë nuk ka ndodhur që të na merret përqindja. Asnjëherë nuk ka qenë 17% – kur Vakati ishte faktor, gjithmonë ishte 44%, 45%, disa vite edhe 47%. Pse ka qenë kështu? Sepse edhe delegatët kishin pjesën e tyre. Sipas ligjit, 41% i takon komunitetit joshumicë. Nëse jemi në koalicion me partinë në pushtet, çdo delegat për mbështetjen e tij merr një përqindje të investimeve kapitale. Si nuk është kjo diskriminim? Shikoni raportet. Do të doja vetëm që drejtori të dalë në foltore dhe të thotë: kemi kaq për Gorën dhe kaq për Opolen, dhe ky është përqindja. Por një raport të tillë nuk e kemi këtu.

Samidin Xheladini: Unë deshta për një fjali të Munirit – nuk e di ju të tjerët a e keni përcjellë – tha kështu: nuk është me rëndësi me shumicën a me pakicën. Domethënë, me vetëdije e paske thënë, edhe kërkush këtu s'ta ka vu mendjen, e mua kjo shumë më brejti. “Naj pokvarenji ljudi” – njerëzit më të prishur të zgjedhur. “Më të prishur”, ti mos më kallxo mu, ti mundesh me i ditë të dy gjuhët, po nuk e dish gramatikën. “Naj povarenji ljudi”. Edhe e dyta, Muniri e kallxoi një sinqeritet shumë të madh. E çka kallxoi, a ia keni vu mendjen? Në kohën kur ka qeveris PDK-ja, demek, komuniteti joshumicë paska qenë i privilegjuar me 47% , 43% dhe 45%. Kujt i janë marrë paratë? Komunitetit shumicë. Diskriminim! Domethënë, Bexhet Xheladini me qeverinë e tij, 41.3% a sa është – edhe strikt – bravo ju qoftë! Nuk ka diskriminim. Bravo, Munir! Hallall të qoftë, je shumë i sinqertë, po e kallxosh të vërtetën. Bravo të qoftë, qeshtu duhet me dalë edhe me e pa opinionin për shkeljet që kanë bo në të kalumen. Ju jeni komuniteti më i privilegjuar në botë. Edhe mburremi na që ju kemi juve këtu si komunitet, besoni që – sidomos LDK-ja – mburremi me ju, sepse kemi qef ne me pas ju privilegje, edhe me pas me marrë, edhe e dimë na që merrni prej Serbisë, prej BE-së, prej Kosovës. I merrni, neve na bëhet qefi. Merrni rroga, e dimë, na bëhet qefi, merrni bre burrë. Nuk po ju themi asgjë. Ka dy rroga, ka tri rroga, merrni, se na po jua japim atë që ju takon prej shtetit të Kosovës. Edhe nuk po duam me ju bo pengesa. Pse ju s'po bënu falënderues? Edhe një send: politikë në qoftë se dojnë me bo në Kuvend, është keq pak. Pse del

keq? Se ne jemi mësuar gjithmonë me punue me ligje. Në momente të caktuara, gabojmë rëndë. Pse? Dijeni mirë, se këta njerëz të PDK-së juve ju kanë mbajtur për interes, nuk ju kanë mbajtur pse ju kanë dashtë. Vetëm për interesa ju kanë mbajtur juve, edhe kur nuk keni dashtë me i ngule me të mirë, i keni ngule edhe me të keq. Ju faleminderit!

Qamil Kolloni: Ndoshta nuk kesh i kuartë, por duke e pas parasysh listën e shpërndarjes, të bëhemi fair play ti edhe unë para delegatëve. Këto paratë, Munir, kanë qenë të ndara vitin e kaluar, qe ku e ke numrin e projektit, prej ku janë marrë i kemi kthye qatë, s'kemi bo kurrfarë diskriminimi. Kemi vetëm një projekt të ri, qe ku të shkruan numri përfundi – 54873 – që ka qenë i miratuar nga Ministria e Financave vitin e kaluar dhe nga qeqy Kuvend. Dhe, janë ndarë 8087 euro që na i ka marrë përmbaruesi, kemi mbetur borxh te operatori, është krye projekti, këtë vit ia japim edhe qatë paret edhe jemi ujku i ngimë e dhentë numër. Edhe e kemi të drejtën këto të hyrat vetanake me i plotësue këto. Kemi X projekte dhe qatë projekte i kemi qit me numra. Janë pra obligime të cilat jemi duke i kryer dhe janë marrë prej komunitetit shumicë, do t'u kthehen qatëre projekteve, qatë projekte të komunitetit pakicë u janë marrë paret, qatëne kanë me iu kthye dhe ky nuk është diskriminim. Këtë unë nuk mundem me e tolerue, se për katër vite asnjë diskriminim nuk është bo, përkundrazi, favore pozitive keni pas në buxhet. Dhe të çohesh e ta politizosh një çështje që me numra është si kristali e pastër – para një muaj ditësh ta kam dhënë Raportin Vjetor Financiar, e ke pa sa jan harxhue për investime kapitale, sa na kanë shkue në suficit prej Mallrave dhe Shërbimeve, sa na kanë shkuar prej Subvencioneve. Të kam thënë, edhe prej Shpenzimeve Komunale na janë marrë për përmbarues, që kërkund në botë nuk lejohet, neve na janë marrë, s'kemi mund me e ndalë. Dhe, të gjitha këto jemi të detyruar me i pas parasysh, me i krye këtë vit, edhe jemi duke e bërë. Tash, çohesh e politizosh, duke u mundue me i nënçmue kolegët tu nga komuniteti, duke u mundue me i nënçmue këta delegatë. Nuk munda me qenë roje, për çdo seancë tënden, duke na mbajtur farse politike. Çohu, bëhu fair play, thuaj nuk ka diskriminim ekonomik në Komunën e Dragashit për komunitetin. Kjo do të ishte më e ndershme për ty, sepse e dish prej vitit 2022 deri më tash sa mjete janë duke shkue për komunitetin boshnjako-goran. Pse ti nuk je në pyetje, ajo është çështje tjetër. Atëherë thuaj unë po due me u pyet, le të dijë populli që ke nevojë ti për trajtim dhe nuk kanë nevojë këta delegatë tjerë.

Munir Jonuzi: Zoti drejtor ka dalë për herë të dytë në foltore dhe për herë të dytë nuk po më jep përgjigje se cili është përqindja e shpërndarjes së mjeteve të papërdorura midis komunitetit shumicë dhe atij pakicë. Nuk po flas përse janë këto projekte këtu. Pozita jonë si delegatë në këtë

kuvend është totalisht e anashkaluar. Sepse duhet të votojmë për këto projekte. Pse? Sepse përmbartuesi privat na ka marrë disa mjete. Dilni dhe thoni që përqindja nuk është 83% me 17%, dilni në foltore dhe thoni "Munir, nuk ke të drejtë." Të gjithë i keni raportet para vetes. Nuk kam përmendur asnjë subjekt politik. Kam folur vetëm për subjektin tim politik. Dhe kam thënë që kur Vakati ishte i fortë në këtë komunë dhe kur përbënte faktor, kurrë nuk ka ndodhur një përqindje e tillë. Të gjithë e dini sa vendime nuk kam mbështetur vitin e kaluar. Dhe isha pjesë e pushtetit. Pse nuk i kam mbështetur? Sepse nuk ishin në interes të komunitetit pakicë. Ju vetë keni shkruar në rrjetet sociale pse e keni prishur koalicionin me Vakatin. Pikërisht për shkak të mosvotimeve të mia. Më keni akuzuar si faktor kyç në prishjen e koalicionit. Sepse nuk kam mbështetur disa vendime që ishin të turpshme për komunitetin pakicë.

Nedžmidin Sejdilar: Duhet të mbrojmë kolegun Jonuzi sepse zoti Koloni nuk dha një përgjigje konkrete. Ju zoti drejtor duhet të jeni të përgatitur të jepni një përgjigje përqindore. Kjo është detyra juaj sepse duhet të punoni me shifra e jo me politikë. Ja, unë këtu publikisht them se nuk na duhen ato 11.000 euro, merrni i harxhoni ku të doni. Ne ua kemi dhënë gjithçka që kemi pasur, ja ku i keni edhe ato 11.000 euro, merrni, shpenzoni si të doni. Ndoshta zotit Hamza i blini një xhip të ri. Është mëkat të paguash 2.000 euro për një servovolant. Koleg Jonuzi më vjen keq që duhet ta them, por ata delegatë të korruptuar janë produkt i Vakati-t tuaj. Si farë e prishur e Vakati-t kanë ardhur në këtë kuvend. Pastaj jeni ndarë. Kjo është një barrë që ju duhet ta mbani vetë dhe ta shpjegoni para qytetarëve. Unë këtë ua kam thënë prej kohësh. E vërteta është që ne këtu në këtë kuvend nuk kemi delegatë të ndërgjegjshëm që përfaqësojnë interesat e qytetarëve, por kemi delegatë që përfaqësojnë interesat e tyre personale. Kjo është komuna e vetme në botë ku burri mund të jetë drejtor dhe gruaja asambleiste. Të gjithë në këtë sallë jemi figura publike, nuk jemi në autobus. Secili ka marrë një barrë mbi vete që duhet ta mbajë. Duhet të mbajë përgjegjësi dhe të pranojë kritika. Po ashtu, edhe unë përballim me kritika dhe kërcënime – përmes rrjeteve sociale më kërkohet koka, më kërcënojnë në telefon, në rrugë – dhe i përballoj. Ju më ndërprisni.

Arijeta Skeraj: z.Sejdilar, në qoftë se ti u ndërhysh njerëzve, Uzairi e ai... ne jemi duke diskutuar për barjten e mjeteve. Në qoftë se s'ke rreth kësaj diçka me thënë, të lutem, unë ta ndërpres fjalën! Ti je duke e bo një politikë këtu, kush është drejtor, kush është asambleiste, gjithmonë jemi duke u akuzuar si femra. Të lutem, në qoftë se tash e mas e përmendish veç një, qoftë asambleist ose ekzekutiv, unë jam e detyruar me ta ndalë fjalën. Ju kisha lut të gjithë asambleistëve që të përqendrohuni në pika të rendit të ditës. Po dalim jashtë kontrollit, një asambleist është marre

gjithmonë ta akuzojë një person. Populli të ka çue për me e ngrit një çështje, e jo me i thënë atij kështu, e atij ashtu. Ne s'jemi të gjithëdijshtëm. Ju kisha lut, përndryshe ta ndërpres fjalën.

Edin Kurt: Zoti drejtor, ju lutem dilni dhe na shpjegoni se sa është përqindja e shpërndarjes së këtyre mjeteve të papërdorura për këtë vit.

Shpetim Hajredini: Nuk e planifikova fare të diskutoj për bartjen e mjeteve vetanake, por pas diskutimeve që u bënë ndërmjet disa asambleistëve dhe drejtorit të Financave, deshta edhe unë të kyçem dhe të jap mendimin tim. I nderuar drejtor, unë nuk e di nëse e ke kuptuar qartë pyetjen që ta ka parashtrur Muniri, por unë besoj që ky diskutimin e bazoi në fakte. Këto mjete vetanake, këtë shumë të cilën po e bartni nga viti 2024 në vitin 2025, ndarjen e kësaj shume, ti, besoj, është dashtë ta bësh konform ligjit. Por, fatkeqësisht, nuk e ke bërë një gjë të tillë dhe, natyrisht, pritet edhe reagimi i njerëzve të cilët janë të votuar nga komuniteti pakicë. Përgjigjet të cilat i dhaje ti, i nderuar drejtor, ma shumë mu m'u duken politike sesa profesionale. Po të them të drejtën. Munirin, sa e kuptova unë, ndoshta edhe përkthimi nuk po është si duhet – unë nuk po e kuptoj edhe shumë qartë – por i gjithë thelbi ishte se ndarjen e mjeteve vetanake nuk e ke bërë konform ligjit. Diçka tjetër nuk kuptova. Edhe një koleg nga radhët e pozitës m'u duk se e bëri një keqkuptim. Përmendi se kinse Muniri ka thënë që në kohën e ekzekutivit të PDK-së, paska marrë përqindje pak më të lartë se që e parashikon ligji, ndërsa tani jo. Por, unë Munirin me sa e kuptova, tha – nëse nuk jam gabim, duhet edhe të më përmirësoj Muniri – pat të bëjë me vitin 2023. Në 2023-tën ju jeni ekzekutiv, ju e keni në dorë timonin e kësaj Komune. Ndoshta jam gabim unë, por po më vjen se e kuptova kështu. Nuk e përmendi qeverisjen e PDK-së, në 2023-tën ju jeni edhe asnjëherë ne nuk kemi qenë kundër që t'iu ndahet edhe më tepër komunitetit pakicë. Atëherë kur është e nevojshme, atëherë duhet t'iu ndahet, kur kemi ne nevojë, komuniteti shumicë, duhet të na ndahet neve. Por, gjithmonë duke u bazuar në ligj, mos me ik prej ligjit, pasi se të gjithë ne synojmë, jemi këtu dhe kontribuojmë për më të mirën e mundshme të komunitetit të cilin ne e përfaqësojmë, ose prej fshatrave prej të cilave vijmë. Ju faleminderit!

Qamil Kolloni: Po më detyroni me ju kërkue falje. Sinqerisht, duke mendue se e keni materialin përpara edhe e keni lexue. Nuk kemi të bëjmë me ndarje, kemi të bëjmë me barjten. Lexone aty fletoren, kqyre çka shkruan: për bartjen e mjeteve vetanake, të cilat janë ndarë tek në shtator, vitin e kaluar, i keni ndarë ju si Kuvend. I keni miratuar, na keni shti në obligime financiare, i kemi bërë projektet. Dhe tash, qato neve na kanë mbet borxh, të 2024-tës me i mbulue, sepse na i ka marrë përmbaruesi. Dhe po shkojmë për secilën shumë veç e veç, me jua sqarue se: në Administratë

92.72 janë para të përbashkëta, janë në Mallra dhe Shërbime me kategori të marrura; nga Zyra e Kryetarit janë subvencione, gjithashtu janë mjete të përbashkëta të komunitetit shumicë dhe pakicë, na janë marrë 1968 euro. Kemi vetëm një projekt të ri, e kemi projektin tjetër “Rregullimi dhe grumbullimi i ujërave – projekti 54807”, që ka qenë i miratuar vitin e kaluar. Mjetet kanë qenë të ndara, se pa qenë të ndara edhe pa qenë të miratuara në Buxhet nuk ka mund me kalue ky projekt. Këto mjete – 8 mijë euro – na janë marrë nga përmbaruesi, i kemi mbet obligim operatorit. I kemi paraparë që pikërisht te qeky projekt me i çue, me e krye obligimin. E ke projektin tjetër, dhe ky është i komunitetit shumicë, vetëm dy projekte të komunitetit goran na i ka marrë mjetet që i kemi pas me shifër, dhe nuk kemi mund ne me bo ndarje tjetër tash në përqindje. Kjo shpërndarje e buxhetit për komunitete është 41.3% për komunitetin goran dhe 58.7% për komunitetin shqiptar, për Buxhetin e vitit 2024. Jemi në vitin 2025, unë jam duke menduar se ju si delegatë po e lexoni me kujdes dokumentacionin që po jua japim, dhe po mundohem me ju dhënë vetëm drejtpërdrejt disa sqarime. Mirëpo, herëve tjera, thoni kështu: kur të vini këtu, na lexoni ju lutem pikë për pikë raportet, edhe fillojmë i lexojmë, kush kupton e kupton, kush s’kupton, s’kupton, ne nuk mundim me jua ndryshue aftësinë e të kuptuarit kërkujt, dhe atëherë jemi okej.

Munir Jonuzi: Zoti drejtor, ju thoni se këto projekte janë votuar vitin e kaluar. Kjo nuk është e vërtetë. Këto projekte janë votuar në shtator të vitit 2023. Përsëri po përpiqeni të manipuloni. Flisni për disa subvencione, unë ju pyes qartë: sa mjete nga fondet e papërdorura për investime kapitale janë ndarë për Gorë dhe sa për Opoljë? Kam llogaritur: 57.000 për shumicën, për komunitetin pakicë kemi 3.223 euro për projektin në Krushevë. Ky projekt është votuar në 2023 për t’u realizuar në 2024, tani jemi në vitin 2025. Nëse gjithçka është votuar, pse na sillni sërish në rend dite të kuvendit? Unë asnjëherë nuk kam kërkuar shpërndarje të drejtë të subvencioneve. Nëse ka më shumë projekte dhe kandidatë nga Opolja, është normale të marrin më shumë mjete. Nëse kemi tre-katër OJQ nga Gora që konkurojnë dhe marrin 20.000 euro, dhe nga Opolja 20 OJQ që marrin 80.000 euro – nuk ka problem. Sepse të dy palët janë respektuar. Kjo përqindje ka qenë gjithmonë e respektuar deri në vitin 2023. Zoti kryetar, kujtojeni si ishit në vitin 2023. Në qendër po jepnit atë që i takonte komunitetit pakicë.

Bexhet Xheladini: Unë kisha kërkuar nga delegatët që, kur janë në pyetje shifrat edhe buxheti, mos të politizojnë gjërat, për arsye se shifrat janë gjëra, që mundim shumë lehtë me e formue një komision edhe me e shqyrtue këtë, a është bërë ndarje e drjetë apo jo. Unë po i marr vetëm dy shembuj, 48 mijë euro kanë qenë mjete të shumicës, të ndara për asfaltimin e rrugës së Rrencit,

vitin e kaluar. 48 mijë eurot, të cilat kanë qenë të shumicës, janë marrë edhe janë qit në një projekt të përbashkët që është për Dragash. Ne kemi mund ato 48 mijë euro me i marrë edhe me i qit në pjesën ku jetojnë komuniteti shumicë, por i kemi qit në bashkëfinancimin e projektit me donatorë, ndërtimi i infrastrukturës, murit mbrojtës dhe ndriçimit në rrugën Dragash – Stadiumi i qytetit. Gjithashtu, në një projekt tjetër, i cili ka qenë ndërtimi i kulmit në fshatin Bresanë, në vlerë prej 21 mijë euro, të cilat po ashtu kanë qenë mjete të komunitetit shumicë, të gjitha ato mjete i kemi qit prapë te një projekt që do të financohet në pjesën e Opojës. Nëse llogariten të gjitha këto, del se ndarja financiare është bërë e drejtë dhe një një përqindje ashtu qysh e ka kërkue ligji – 41.3%. Për të gjitha këto, për pikën e dytë të rendit të ditës, që u debatua, për të gjitha këto projekte që janë këtu, janë edhe arsyetimet, në të dy gjuhët – i keni lexue, s’kam nevojë me i shpjegue. Siç e dini, te pika e dytë, këto mjete janë bart në projektet të cilat, ose nuk janë përfunduar vitin e kaluar, ose për shkak të mungesës së mjeteve që i ka marrë Ministria e Financave për pagesën e Kontratës Kolektive. Kështu që këto mjete është dasht pa tjetër, si borxhe, me i alokue në ato projekte të cilat nuk kanë qenë të përfunduara. Në këtë drejtim, nuk ka paqartësi, nëse dikush mendon se është bërë e padrejtë ndarja financiare, lirisht le ta formojnë një komision, edhe në atë komision të gjithë le të jenë të komunitetit joshumicë edhe le ta vlerësojnë. Por, unë jam shumë i bindur se këtu nuk ka kurrfarë diskriminimi, mund të ketë vetëm diskriminim pozitiv. Kështu që, unë u propozoj delegatëve që kjo pikë e rendit të ditës të votohet, edhe nëse dojnë le ta formojnë një komision edhe ta vlerësojnë. Por, sa i përket diskriminimit të investimeve kapitale, unë prej se kam ardhë kryetar, asnjëherë nuk ka pas diskriminim sa i përket ndarjes së drejtë financiare për investimet kapitale. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush rreth kësaj pikës me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 20 vota pro, 1 kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë edhe pikën e dytë. Po vazhdojmë te pika e tretë: Propozim-vendimi për rialokimin e mjeteve të Buxhetit për vitin 2025.

Shpetim Hajredini: Po detyrohem patjetër që të kaloj edhe një herë në pikën e parë që e diskutuam, për bartjen e mjeteve vetanake, pasi që drejtori u mundue pak me na ulë poshtë neve, se na s’po dikemi me lexue. Unë gjithmonë mundohem, edhe pyetjet drejtor kur t’i parashtroj, t’i parashtroj në mënyrë profesionale, po qekjo besoj që mu s’me çon peshë edhe s’merrem, ti e dish, me këto sende s’merrem. Por, po e merr po e lexon komplet nenin, masnej po vazhdon gabim po e lexon. Mu është problem me m’lajthit në këtë drejtim, me tjerët mujsh me bo diçka. Mjetet

vetanake të buxhetuara për vitin 2024, të grumbulluara më tepër në raport me planin – besoj jam i qartë, qytetarët le ta kuptojnë – kapin shumë prej 58,862.16 euro. Mjetet e pashpenzuara nga Fondi 21 dhe 22, për vitin 2024 kapin shumë prej 28,377.08 euro. Gjithsej, shuma e grumbulluar më tepër – po e potencoj edhe një herë – më tepër në raport me planin, si dhe mjetet e pashpenzuara në Fondin 21 dhe 22, kapin shumë në total 87,239.24 euro. A përmendi këtu dikund naj projekt, naj send qetu, subvencion diçka? Jo! Pra, për me qenë i qartë dhe shumë i drejtpërdrejtë me ty, drejtor – edhe me qytetarët, le ta kuptojnë – mjetet vetanake, ti, së bashku me ekzekutivin në tërësi, i drejton ku të duash ti. Të jemi të qartë në këto gjëra. Në ato projekte që ti e sheh të arsyeshme që duhet me i dërgue. Në këtë rast, për shembull, ta ka marrë përmbaruesi, prej këtyre projekteve t'i ka marrë paret, ti obligohesh me i bart në këto projekte. Shumë e thjeshtë, nuk ka nevojë për diskutim më tepër. Por, me m'qit poshtë s'mujsh, edhe e dish këtë. Por unë kam qef – se kam respekt të madh për ty – pyetjen edhe diskutimin e bëj shumë qartë, profesional, nuk dal në politikë. Ndërsa tjetra, sa i përket rialokimit të mjeteve, mu po më vjen shumë mirë që po e bëni një gjë të tillë, që shuma më pëlqeu shumë. Por, deshta ta di arsyeshmërinë e rialokimit të këtyre mjeteve nga këto projekte në projektet tjera. Besoj që ti e ke një arsyeshmëri se pse është bërë bartja e këtyre mjeteve në projekte tjera. Dhe pastaj, pas përgjigjes, shpresoj që nuk do të kem nevojë më të dal të replikoj, por nëse është e nevojshme, atëherë dal prapë dhe e diskutojmë.

Munir Jonuzi: Deklarata e kryetarit më detyroi të sqaroj disa gjëra. Thoni që për asfaltimin e rrugës Kapre-Rrence merrni 48.000 euro nga Opolja dhe i vendosni te fondet e përbashkëta për bashkëfinancim. Kjo nuk është në Gorë, është në fondet e përbashkëta. Prapë, përqindja mbetet e njëjtë. Nëse llogaritni që Dragashi është vetëm pjesa gorane, atëherë është në rregull. Kjo nuk e zvogëlon përqindjen. Ju mund t'ju kujtoj rishpërndarjen e fondeve të vitit të kaluar. Kishim 90.000 euro, prej tyre 72.000 ishin për Gorë, 19.000 për Opoljë. Si i ndamë ato fonde? Dhamë 54.000 për Opoljë dhe vetëm 19.000 për Gorë. Më pas patëm mosmarrëveshje për të cilat thatë se ishin arsyeja për prishjen e koalicionit me Vakati-in.

Bexhet Xheladini: Ka mundësi që më keni keqkuptuar, por unë thashë – këto mjete, asfaltimi i rrugës Kapre-Rrenc, në vlerë prej 48 mijë euro, janë miratuar nga buxheti i vitit të kaluar. Kanë qenë mjete të ndara për komunitetin shumicë. Këto mjete, tani, ne kemi mujt me i çue në një projekt të komunitetit shumicë, por i kemi çue për një projekt të përbashkët. Kur të bëhet ndarja e drejtë financiare, në fillim të vitit – këtë vit, për shembull, kur ta bëjmë ndarjen e drejtë financiare për vitin 2026 – ne, në bashkëpunim me Zyrën e Komuniteteve, me nënkryetarin e komuniteteve,

në bashkëpunim edhe me asambleistët e juaj, edhe drejtorët, ulemi dhe përcaktohemi se sa mjete nga buxheti i investimeve kapitale do t'i ndajmë si mjete të përbashkëta. Edhe ato nuk hyjnë në ndarje. Në ndarje hyjnë vetëm mjetet të cilat shkojnë për investime kapitale në pjesën e Opojës, edhe në pjesën e Gorës. Kështu që, këto mjete vitin e kaluar kanë qenë për komunitetin shumicë. Këto kanë teprue, për arsye se kur është shpallë tenderi – buxheti është miratue në shtator, kur është shpallë tenderi, një kompani ka hy ma lirë sesa mjetet që janë paraparë me buxhet. Ne i kemi ndarë 200 mijë euro, edhe këto mjete kanë teprue. Tash, këto mjete ne i kemi orientue në financimin e një projekti të përbashkët. Kështu që, unë po shkoj me rend, pse e kemi bërë një gjë të tillë, domethënë, këto 48 mijë euro i kemi çue te një projekt i përbashkët; 21 mijë euro për ndërtimin e mbulojës së stadionit, të cilat po ashtu kanë qenë të parapara me buxhetin e vitit të kaluar, ku këto mjete kanë tepruar, dhe këto mjete pastaj i kemi qit në një projekt të komunitetit shumicë, në Bresanë, për asfaltimin e rrugës Bresanë – Bjeshkë. Gjithashtu, te ndërtimi i Impiantit për pastrimin dhe filtrimin e ujit për projektin kryesor, me buxhetin e vitit 2024, për vitin 2025 kemi paraparë më shumë mjete sesa që ka hy kompania që e ka marrë tenderin, dhe tash 130 mijë euro të cilat ne i kemi marrë prej aty, i kemi ndarë në disa projekte, projekte të cilat është dashtë që të përfundohen këtë vit, ose i kemi mbet borxh nga vitet e kaluara, ose ato mjete i ka marrë përmbaruesi. Gjithashtu, nga këto mjete që janë marrë prej impiantit, 100 mijë euro ne i kemi orientuar në projektin kryesor për ndërtimin e ujësjellësit, për arsye se përmbaruesi prej këtij projekti vitin e kaluar na i ka marrë 500 mijë euro. Ne tani jemi të obliguar që në buxhetin e vitit 2025, kur ta miratojmë për vitin 2026, t'i ndajmë edhe 400 mijë euro me e mbulue pjesën e mjeteve që na duhen për përfundimin e projektit të Ujësjellësit. Gjithashtu, vitin e kaluar përmbaruesi na i ka marrë diku afër 16 mijë euro nga projekti për ndërtimin e parkut në qytezën e Dragashit, dhe këto mjete të përbashkëta që janë për Impiantin, i kemi marrë dhe i kemi qit prapë për financimin e një projekti të përbashkët në Komunën e Dragashit. Ky është ai arsyetimi im që desha t'ua jap delegatëve, që ta kenë më të qartë pse është bërë ky Propozim-vendim për rialokimin e mjeteve të Buxhetit për vitin 2025.

Artan Loshaj: Rreth pikës së tretë për rialokimin e mjeteve, më vjen mirë edhe mua, si shefit të Grupit tonë, që i keni ndarë këto mjete. Por, unë deshta, kryetar, me e bo një shqetësim, se kur keni ardhë si kryetar, keni thënë që punimet do të jenë të nivelit të lartë, punimet do të jenë me standarde evropiane. Këto 48 mijë euro që i keni ndarë në rrugën Kapre – Rrenc, është mirë që i keni ndarë. Unë due me të pyet ty – se premtimi është borxh – na ke premtue që kur të ndërtohet

kjo rrugë, do të ndërtohet edhe muri mbrojtës tek varrezat e fshatit Rrenc. Më ke premtue në muajin nëntor, më ke thënë që në pranverën e vitit 2025 do të bëhet. Me këto mjete, a do të bëhet edhe ndërtimi i murit mbrojtës, dhe problemi tjetër është që shqetësimi im edhe i shumë qytetarëve është se këto punime që janë duke u bërë, janë punime të dobëta. Edhe, kërkoj nga ju që nga mbikëqyrësi i këtij projekti t’i hapni sytë pak edhe të bëhen projekte të nivelit më të lartë. Qe edhe kamerat, qe çfarë rruge kemi në Kapre – Rrenc. Uji e ka mbulue rrugën, poshtë rrugës i ka marrë uji ato livadhet. Kjo është e dobët, atëherë kërkoj nga ju që këto mjete që i ndatë – sepse janë para të qytetarëve – të bëni presion, le të bëhen punime të standardeve si keni premtuar. Tjetra është njëjtë, edhe 48 mijë euro keni me i nda në bashkëfinancim me donatorë, tek Stadiumi i Dragashit. I njëjti problem është, kryetar. Në nëntor, kur është bërë rruga për në Stadium, ndriçimi edhe shëtitorja – ja ku janë futur anësoret. Vetëm një shtresë beton e kanë qit edhe aty i kanë shtrur anësoret. Me siguri tash ato anësoret do të bien. Jo kryetar, s’ka përfundue po i keni vu këto. Videon tjetër e keni, ja shiko murin mbrojtës, ku do të bëhet shëtitorja, me çfarë standardi është kjo? Unë po kërkoj nga ju- shumë mirë keni bo që 48 mijë euro i keni ndarë – por këso punime nuk tolerohen, se janë shumë të dobëta. Edhe, pasi po diskutojmë për stadium, vitin e parë ka qenë 50 mijë euro, një urgjencë e madhe për stadiumin e fshatit Blaç. Çka po ndodh me atë stadiumin, pse nuk keni ndarë mjete? Në vitin e katërt jeni, pse nuk keni ndarë mjete në vitin e dytë, tretë dhe tash, se e keni pas shumë urgjent stadiumin, ka qenë vitin e parë. Po dalim në fund te 100 mijë euro tek Ujësjellësi. Premtimi juaj, kryetar, ka qenë që gjatë mandatit tuaj këto punime do të kryhen. Nuk është e ndryshme, jam duke diskutue rreth rialokimit. 100 mijë euro i keni ndarë për Ujësjellësin qendror. Po thoni që përmbaruesi i ka marrë 400 mijë euro. Ju keni premtuar për këtë Ujësjellës që në mandatin e juaj do ta përfundoni, në 2025-tën. Tash, më herët diskutuat, thatë edhe 400 mijë euro do t’i ndajmë për vitin 2026, për me përfundue. Domethënë, edhe ky është një premtim i dështuar i juaji, i kësaj qeverisje të juaj.

Bexhet Xheladini: Sa i përket murit mbrojtës te varrezat, ne si ekzekutiv do t’i propozojmë Asamblesë që në buxhetin e vitit 2026 të ndahen mjete për ndërtimin e murit të varrezave. Gjithashtu, ke qenë edhe shumë skeptik lidhur me ndriçimin në fshat, shumë herë e ke përmend ku janë paratë, ku do të gjenden paratë. Ja, në pikën e dytë të rendit të ditës u miratuan mjetet, dhe ky ka qenë një premtim i imi të cilin e kam mbajtur, ti ke qenë shumë skeptik edhe shumë ke dyshue që kjo nuk do të bëhet, por ja që po bëhet. Sa i përket rrugës së Rrencit, sigurisht e ke lexue një reagim të një qytetarit të fshatit Kapre, që e ka bërë për këtë ujin që po del aty. Por nuk është faj

te ne, as te punëkryesi. Në pjesën ku është ndërtue edhe ku është asfaltue ajo rrugë, edhe ku është bërë problem uji, punëkryesi e ka qit gypin për bartjen e ujit nga njëra anë në anën tjetër të rrugës. Mirëpo, një pronar i cili e ka pas aty pronën, ka dalë e ka kundërshtue ndërtimin e kokës hyrëse të atij ujit. Përveç që e ka kundërshtue, ai ka qit aty edhe zhavor, dhe e ka mbyllë atë gyp. Një qytetar me mbiemrin Flugaj, që e ka pronën aty, e ka mbyllë, edhe si pasojë e mbylljes së gypit, tash uji nuk po mund me kalue prej njëres anë në anën tjetër. Dy herë punëkryesi ka tentue me shkue me e çelë atë gyp, po ashtu edhe ne si Komunë, edhe zjarrfikësit kanë qenë me mujt me e çelë, mirëpo ishte e pamundur me u çelë, sepse është qit aty një tucanik, zhavorr brenda, është betonizue ajo brenda edhe s'po mundet me u çelë. Mirëpo, ne kemi biseduar me punëkryesin, tash kur të vjen me e asfaltue pjesën e mbetur të rrugës në drejtimin Kapre-Rrenc, ka me e pre asfaltin, ka me e vendos një gyp të ri, edhe ka me e asfaltue, edhe ky problem ka me u zgjidhë, mirëpo deri më tash kushtet atmosferike nuk e kanë lejue një gjë të tillë. Sa i përket punimeve në drejtim të stadionit, ky është projekt dyvjeçar, ky projekt ende nuk ka përfunduar. Komisioni për pranimin e punimeve ende nuk është formue. Për atë arsye ne i kemi ndarë vlerën prej 48 mijë euro, që me këto mjete këtë vit do të përfundojë tërësisht ai projekt, dhe sigurisht do të ndërtohet edhe shëtitorja, edhe staza për ecje, edhe ndriçimi do të shkojë deri në stadiumin e qytetit. Ndërsa, sa i përket stadiumit në fshatin Blaç, është e vërtetë që aty ka pas ngecje të punimeve, për arsye se një investitor, një donator i cili e ka dhënë fjalën që pjesën tjetër të punimeve do ta bëjë ai, ai ka pas disa probleme financiare me kompaninë e vet në Austri, edhe tash ai nuk është në gjendje me e bo një gjë të tillë. Ne këtë vit kemi paraparë mjete për investime në atë stadium, dhe është në përgatitje tenderi për përfundimin e punimeve të stadionit në fshatin Blaç.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush rreth kësaj pikës me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro kësaj pikës? A ka kundër? Abstenim? Me 20 vota pro, zero kundër dhe 3 abstenim, e miratojmë edhe pikën e tretë. Atëherë, vazhdojmë pas pauzës!

Atëherë, po fillojmë me pjesën e dytë të seancës. Po vazhdojmë me pikën e katërt. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen e Listës së Përgjithshme dhe Listës së Veçantë të pronës së paluajtshme të Komunës për vitin 2025.

Driton Ademi: Atëherë, unë nuk do të hyj në detaje shumë te pikat e rendit të ditës, por unë e kam një pyetje. Ky është viti i tretë që drejtorit ia bëj një pyetje, pse nuk po na bjer me emra. A ka ndërmend me i pru me emra, se mandati i shkoi, kur ka me i pru me emra? Për këtë arsye, edhe vitet e kaluara nuk e kam votue, përderisa i kam kërkue me i pru me emra. As këtë vit nuk i ka pru

me emra. Kështu që, unë personalisht jam kundër këtyre. Megjithëse është një procedurë shumë e lehtë, po drejtori e bën qaq të madhe, që priton me punue për me i pru me emra. Viti i tretë është që nuk i bjer me emra. Kështu që ne nuk e dimë, neve po na duhet me hi me i pa secilin, me identifikue secilin vend, edhe me i pa a janë qato a jo.

Qamil Kolloni: Delegat i nderuar, besoj se e kemi diskutue disa herë, nuk është problemi teknik, se është problemi më i vogël me ia shtue edhe një emër. Është një mënyrë e cila jepet raport në të gjitha komunat, bëhet publike. Edhe tash, qajo del aty, është shumë lehtë përmes geoportalit me e ditë edhe lokacionin, përmes qatij numrit të parcelës, se për cilin lokacion bëhet fjalë. Në momentin kur dalin ato, dalin për me u dhënë në shfrytëzim. Konkurrentët mund të jenë të ndryshëm, edhe u jepet qasje e barabartë të gjithëve. Për këtë arsye, ata të cilët janë të interesuar, i kqyrin këto edhe bëjnë kërkesa, aplikojnë për me i marrë në shfrytëzim. Nuk ka ndonjë problem, se shumë më lehtë e kemi edhe emrin me ia shtue atje, Bresanë apo Dragash. Të fshatrave janë, vetëm nuk tregon në cilën lagje. Të Dragashit i ke, të fshatrave i ke, vetëm është që nuk del skica, se skicat mund të nxirren sot prej gjeoportalit dhe çdokush që është i interesuar munden me i nxjerrë. Nuk besoj që ka ndonjë sekret pse kjo bëhet kështu. Më së lehti për shërbimin është që me e shtue edhe një kolonë edhe me ia vu edhe një shënim tjetër, por besoj që nuk ka nevojë.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me vota 19 pro, 1 kundër dhe 2 abstenim, e miratojmë edhe pikën e katërt. Vazhdojmë me pikën e pestë: Propozim-vendimi për emërimin e Komisionit për Përzgjedhjen e Drejtorëve në Institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Dragashit.

Driton Ademi: Atëherë, unë kisha pas dëshirë, te këto pikat kur vijnë të sponzorizime, është mirë një herë me dalë qeverisja për me dhënë një sqarim pak më të gjerë. Por mu diçka që më ka ran a sy te qeky për formimin e Komisionit: “Komisioni Përzgjedhës është Ad Hoc dhe mandati tij përfundon me nxjerrjen e vendimeve përfundimtare për zgjedhjen e kandidatëve në pozitat e kërkuara në konkurs.” Unë nuk e di ku e keni marrë këtë, që e keni shkruar këtu. Nuk po e shoh tash ku është drejtori i Arsimit, por me sa e di unë, këut në UA të MASHTI-t, te Neni 6, Nr.150/2020... unë këtë e gjeta të fundit. Tash ti mundesh me thënë të shqfuqizuet edhe mundesh me ia bo edhe dikujt me gisht mos me folë ose me folë, por këtë Udhëzim Administrativ të fundit unë këtu e gjeta. Për këtë kam fol unë, e treta vjet jam duke folë. Më kallxo ti mu, në çfarë komisioni, ku e ke marrë këtë Ad Hoc komision, ku ka komision Ad Hoc? Në UA nuk ke komision

Ad Hoc. Plus e ke shkruar që përfundon me nxjerrjen e vendimit. Shumë mirë e kemi diskutuar na edhe vitin e kaluar, komisioni ka mandat 1 shtator të vitit 2024, po e marrim shembull, deri më 31 gusht të vitit 2025. Ju keni bo shkelje edhe të mëhershme. Kjo është shkelja e fundit, edhe vjeta e fundit e mandatit është që jeni duke e bo prapë këtë shkelje. Qëky komision, duhet me e ditë që as nuk mund me qenë Ad Hoc, në bazë të UA, as me përfundimin derisa ta nxjerrë vendimin. Kush munden me m'kallxue mu që vendimin munden me e nxjerrë në nëntor, a ka afat ai komision? Ose në dhjetor me u përzgjedhë drejtorët. Është mirë këtu, këtë pjesën me e hek, edhe është mirë me e shtue te pjesa në bazë të Udhëzimit Administrativ, ky komision ka mandat deri në fund të vitit shkollor, që i bjer deri më 31 gusht 2025. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, pasi nuk është këtu drejtori i Arsimit, po e jap një sqarim të shkurtë, kështu që në pikën eventuale mund të ju jap ai sqarime pak më të hollësishme. Udhëzimi Administrativ i MASHTI-t ka ndryshuar dhe ka dalë i riu, unë nuk e di me numër sa është, po më duket është aty në atë vendimin, keni mujt me e lexue. Ky komision do të vlejë vetëm për një konkurs. Arsyeja është sepse anëtari i komisionit nga MASHTI nuk po munden nëpër krejt Kosovën me shkue nëpër konkurse që po i shpallin. Ne planifikojmë që të shpallim konkursin për 2-3 drejtorë të shkollave, për të ndjerin Naserin dhe ka edhe disa drejtorë të tjerë të cilët duhet t'i zgjedhim. Tash, ai komisioni ka me vlejë vetëm për një konkurs, kur të kryhet ai konkursi më ky komision nuk vlen, duhet me e zgjedhë Asambleja një komision tjetër, eventualisht për ndonjë konkurs tjetër. Kjo është, për atë quhet edhe komision Ad Hoc, do të vlejë vetëm për një konkurs. A i shpallëm na për një drejtor, dy apo tre drejtorë, ky komision ka me e krye qet konkurs, edhe pastaj herën tjetër duhet me e zgjedhë një komision të ri.

Munir Jonuzi: Sa i përket anëtarëve të propozuar për drejtorë të shkollave, nuk do ta komentoj këtë, besoj në angazhimin e tyre. Kur shohim se cilat shkolla janë të përfshira në këtë vendim, arrijmë në përfundim se drejtorja e arsimit është shumë aktive kur duhet të zgjidhë problemet e komunitetit shumicë dhe kur duhet të shpallë konkurse për drejtorë shkollash. Sa i përket shkollës së tretë, drejtori i asaj shkolle në muajin maj do të shkojë në pension. Të shohim si do të veprojë kjo drejtori në përzgjedhjen e drejtorit për komunitetin pakicë. Që dy vjet e gjysmë në shkollën e Restelicës kemi një ushtrues detyre (UD) që nuk i plotëson kushtet as për emërim të përkohshëm. Sipas udhëzimeve administrative dhe ligjit, UD aktual nuk i plotëson kushtet për emërim. Nuk e di në ç'mënyrë e ushtron funksionin. Gjatë këtyre dy vjetëve e gjysmë është shpallur konkurs vetëm një herë. Ai konkurs ka dështuar për arsye se nuk janë ftuar anëtari i këshillit të prindërve

dhe anëtari i këshillit të shkollës. Kush nuk i ka ftuar? Drejtorja e arsimit. Dhe ky ka qenë obligimi i tyre. Kjo na çon në përfundimin se vetë drejtorja ka sabotuar procesin e zgjedhjes së drejtorit të shkollës. Propozimi im është që në këtë vendim të përfshijmë edhe zgjedhjen e drejtorit për shkollën fillore në Restelicë.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me vota 13 pro, 5 kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë edhe pikën e pestë. Vazhdojmë te pika e pestë: Propozim-vendimi për anulimin e vendimeve për shpalljen e interesit publik, siç i keni me numra, që mos t'i lexoj të gjithë. A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike?

Bexhet Xheladini: Siç e dini, në asamblenë e kaluar kryetari i Komunës ka propozuar që për këto pronat të cilat janë të shënuara në pikën e gjashtë, të shpallet interesi publik për këto prona, për nevojat e Komunës. Gjithashtu, unë si kryetar i Komunës, paralelisht me Vendimin e Asamblesë që është bërë për shpalljen e interesit publik, e kam dërguar të njëjtin dokumentacion në Departamentin e Shpronësimit në MMPHI. Në të njëjtën kohë, në njëërën anë, derisa MAPL-ja na ka prurë një vendim që KK të bjerë një vendim për anulimin e këtyre vendimeve, sepse, sipas tyre, nuk ka pas nevojë Asambleja me e kërkuar shpalljen e interesit publik, por mundet drejtpërdrejt kryetari. Mirëpo ne, për me e përmbush obligimin ligjor, është mirë që ne këto vendime t'i anulojmë, sepse ne kemi marrë tash vendime tjera, jau kam dërgue tash në email, që kemi marrë leje nga ana e Departamentit të Shpronësimit që këto procedura të fillojë Komuna që t'i zhvillojë. Ne tash do ta formojmë komisionin, i cili do ta përgatit elaboratin për këto prona, dhe pastaj do ta çojmë në Departamentin e Shpronësimit për me e bo pagesën Komuna, për nevoja të saj. Kështu që ne jemi interesuar, kemi folë në telefon me zyrtarë të ndryshëm në ministrinë përkatëse. Edhe aty ka dualizma, disa thonë nuk është bo mirë që nga ministria është kërkuar me i anuluar këto vendime, sepse është Asambleja ajo e cila shpall interesin publik, mirëpo disa tjerë thonë se kjo nuk është shumë e rëndësishme, por Asambleja duhet me e anuluar këtë. Arsyeja është sepse në ministrinë përkatëse, sidomos në MAPL, po ndërrojnë shpesh këta mbikëqyrësit e komunave dhe ata po kanë qasje të ndryshme ndaj proceseve të ndryshme. Kështu që, unë propozoj që Asambleja, për me e përmbush obligimin ligjor, ta bëjë anulimin e këtyre vendimeve, ndërsa ne si Komunë, masi e kemi marrë dritën jeshile për këto prona nga ana e Departamentit të Shpronësimit, do ta përgatitim elaboratin dhe do ta çojmë në Departament për me e vlerësuar pronën, pastaj të fillojë procesi i pagesës. Faleminderit!

Shpetim Hajredini: Edhe pse në email nuk e pashë, nuk më paska ardhë mu, ndoshta e kam prapë problemin e njëjtë me këtë emailin, por edhe sikur të më kishte ardhë e ta kisha lexuar tash, nuk kishte ndryshue në qëndrim, e as në vendim timin, të cilin e kam marrë më herët. Ne e kemi diskutuar shumë herë – disa herë më ka replikuar edhe prej vendit një koleg asambleist – edhe kam thënë gjithmonë që po i bini vendimet duke mos marrë informacione prej njerëzve adekuatë ligjorë, të cilët e njohin ligjin, edhe po na kthehen ato mbrapsht gjithmonë. Nuk e di tash nëse ka ndodhë një vendim me e marrë e nuk na u kthye prapë, deri sot. Po biem shumë poshtë, në nivel shumë të ulët. Nuk jemi njerëz të cilët nuk dimë me lexue, ne dimë me lexue, kemi njerëz shumë profesionalë të cilët e njohin ligjin, edhe mos me e njoftë ligjin, e lexojsh ligjin. E pse po i bëjmë këto gjëra, po e lejojmë një gjë të tillë, me na u kthye vendimet prapë, e di vetëm ekzekutivi, unë për veti s’po muj me e kap, me e akceptue. Tash shumë i qartë ke kryetari, më pëlqeu shumë fjalimi. Po pse bre kryetar me kohë nuk e ke bo një gjë të tillë? Me i marrë informacionet e duhura, na i bijshe këtu, e merrshim vendimin si duhet, edhe sot s’kishim pas nevojë me e diskutue, me na i kthye prapë ata, me bo lojëra me ne. Por, megjithatë, unë nuk jam kundër, unë jam për të mirën e këtij vendi, por keni kujdes, bile këto muaj që i kemi para, vendimet të cilat i marrim, t’i marrim duke u bazuar në ligj. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me vota 18 pro, zero kundër dhe 3 abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Atëherë, vazhdojmë me përgjigjet e ekzekutivit për pyetjet e parashtruara nga asambleistët nga seanca e dytë.

Bexhet Xheladini: Atëherë, në seancën e kaluar, z.Munir Jonuzi m’i ka bërë disa pyetje me shkrim. Unë do të mundohem t’i përgjigjem në fillim këtyre pyetjeve. Pyetja e parë ka qenë a ka përfundue asfaltimi i rrugëve në pjesën e Gorës, nga Granti qeveritar, dhe a është ndarë për qindja e këtij Granti në bazë të ndarjes së drejtë. Asfaltimi i rrugëve në pjesën e Gorës, në bazë të projektit që kemi konkurrue në ministri, është përfunduar, punimet janë pranuar edhe nga ana e Komunës, edhe nga ana e përfaqësuesve të ministrisë, dhe në këtë drejtim, të gjitha mjetet e Grantit të Performancës që i kemi marrë vitin e kaluar janë ndarë në proporcionin 41.3%. Një pjesë e këtyre mjeteve janë shpenzuar në pjesën e Gorës, një pjesë në atë të Opojës, dhe një pjesë janë shpenzue për asfaltimin e kësaj rrugës këtu, nga qendra e Dragashit për në QKMF, edhe për blerjen e një traktori. Këto janë bërë nga mjetet e përbashkëta. Nëse ka dikush dyshime për ndarjen e drejtë të këtyre mjeteve, mundet lirisht Asambleja me e formue një komision edhe me e vërtetue këtë.

Pyetja tjetër është bërë, kur planifikohen të mbahen manifestimet kulturore në Komunën e Dragashit. Manifestimet kulturore të cilat i mbajmë ne, zakonisht i mbajmë në kohën kur vijnë bashkatdhetarët tanë, sepse shumica prej këtyre manifestimeve janë të dedikuara për Mërgatën e Komunës së Dragashit. U kërkua që në vendimin e bursave janë vërejt edhe disa vendime tjera, kështu që z.Muniri ka pyet se cilat janë ato vendime. Siç e dini, bursat ndahen nga të hyrat vetanake dhe ato janë subvencione, sikurse subvencionet për bujqësi, për subvencionet e Zyrës së Kryetarit, të kulturës. Nga këto mjete, kur kanë teprue nga bursat, janë bërë tri vendime për mbulimin e shpenzimeve të tre nxënësve që janë me nevoja të veçanta, që udhëtojnë jashtë Komunës sonë. Një prej tyre është edhe që udhëton në Komunën e Pejës, është një person me nevoja të veçanta. Sa i përket punimeve shtesë, janë përmend shtatë punime shtesë të disa projekteve. Siç e dini, me ligj, menaxheri i projektit i bën kërkesë kryetarit të Komunës, sepse në projektin që është paraparë, ose për shkak të lëshimeve të ndryshme në projekt, ose për shkak të shitjes së dheut, për shembull, e parasheh ai nevojën për punë shtesë, ia bën kërkesën kryetarit. Mirëpo, unë e kam bërë një praktikë, që punimet shtesë nuk i pranoj vetëm në bazë të propozimit të menaxherit, unë në atë moment e formoj një komision prej tre anëtarësh-inxhinierësh, të cilët dalin në vend të ngjarjes dhe ata e bëjnë inspektimin dhe e vërtetojnë a ka nevojë me bo punë shtesë apo jo. Nëse ky komision vjen me një rekomandim që duhet të bëhen punë shtesë, unë si kryetar ato i miratoj, mirëpo për to hapet tender i posaçëm dhe kanë të drejtë të konkurrojnë, jo vetëm ajo kompani që e ka pas punën, por edhe të gjitha kompanitë tjera. Një pyetje tjetër ishte pse është bërë pagesa për TV Prizrenin. Siç e dini, vitin e kaluar kemi pas në vizitë ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar. Në atë kohë, unë si kryetar i Komunës e kam thirrë edhe TV Prizrenin, edhe për atë prezencë të tyre ne e kemi bërë edhe pagesën. Është pyet se pse janë bërë dy pagesa për shpronësim dhe cilat janë ato. Njëra pagesë për shpronësim është bërë për shitoren e Sharr Prodhimit në Bresanë, dhe është bërë me mjetet e komunitetit shumicë. Është ajo shitorja që kanë qenë ngjitur me ish-Stationin Policor në Bresanë. Pagesa e dytë është bërë kur është bërë shpronësimi i tokës në fshatin Zgatar, në të cilën tokë është ndërtuar shkolla e fshatit, ku në atë kohë, ata të cilët e kanë ndërtuar, e kanë ndërtuar tokën në pronë të bashkësisë islame. Pastaj, Bashkësia Islame përmes procedurave që i ka ndjek këtu në Asamble, edhe procedurave tjera, na ka ardhë vendimi që ne duhet t'i paguajmë 135 mijë euro për shpronësimin e asaj toke. Unë si kryetar i Komunës e kam bërë një marrëveshje me Bashkësinë Islame, që këto mjete t'i paguajmë me tri rata, brenda dy viteve. Është pyet se çka është puna me autobusin për bartjen e nxënësve të komunitetit joshumicë. Ne kemi bërë disa kërkesa për KFOR-

in Turk dhe LMT-në për sigurimin e këtij autobusi, por për fat të keq deri tash nuk kemi përgjigje edhe nuk kemi mundur ta sigurojmë. Si është bërë njoftimi i popullatës për pagesën e shpenzimeve të ndriçimit publik. Siç e dini, unë si kryetar kam marrë një vendim që të gjitha fshatrat të cilat kanë të instaluar ndriçimin publik t'u bëhet pagesa. Njoftimi është bërë përmes uebfaqes së Komunës, Facebook-ut të Komunës, mjeteve të informimit në të dy gjuhët dhe deri më tash të gjitha fshatrat ku e kanë të instaluar ndriçimin publik kanë bërë kërkesë për pagesën e tyre, dhe në shumicën dërmuese të tyre, me sa e di unë me të gjitha, kemi filluar pagesën. Kjo procedurë po shkon përmes Drejtoratit për Emergjencë. Pyetja e fundi ka qenë nga cilat drejtorate vijnë kërkesat për punësime. Përgjigja është se këto kërkesa kanë ardhë prej Drejtorisë së Administratës, QPS-së dhe QKMF-së. Dua të ju njoftoj edhe për diçka, për të cilën është bërë shumë zhurmë në mjete të informimit, sidomos nga LVV – Qendra në Sharr, nga Dega e PDK-së në Dragash, nga Filiz Mustafa, i cili ka qenë në lidhje direkte me Radio Dukagjinin, për punësimin e tre personave të cilët janë punësuar në Komunën e Dragashit. Lënda ka shkue edhe në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, ka shkue edhe në Antikorrupsion. Ne i kemi marrë përgjigjet prej këtyre dy institucioneve, për punësimin e këtyre tre personave. Është fjala për Brendi Berishën, Fari Kollonin dhe Vetim Ramadanin. Për Brendi Berishën dhe Fari Kollonin na ka ardhë përgjigja më herët nga Agjencioni Antikorrupsion, dhe është thënë se procedurat e punësimit të këtyre dy personave kanë qenë ligjore dhe nuk ka pasur konflikt interesi për këta dy persona. Gjithashtu, për Vetim Ramadanin, përveç që na ka ardhë përgjigja nga Agjencioni Antikorrupsion, që nuk ka pas konflikt interesi me rastin e zgjedhjes së tij, gjithashtu edhe nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës n aka ardhë konfirmimi gjatë punësimit të Vetim Ramadanit nuk është shkelë në asnjë rrethanë, asnjë procedurë e ligjit. Kështu që, vetëm deshta të ju informoj juve dhe opinionin publik, që për këta tre persona të punësuar nuk e kemi shkelë as ligjin, dhe nuk ka pas konflikt interesi gjatë zgjedhjes së tyre. Unë këtë deshta ta them, në pikën eventuale nëse ka ndonjë pyetje për mu, unë do të dal prapë. Lidhur me këtë kam qenë i obliguar që t'ju njoftoj që ne, edhe pse jemi akuzuar, jemi akuzuar pa bazë, akuzimet kanë qenë politike dhe punësimet kanë qenë konform bazave ligjore. Kush nuk beson, në seancën e ardhshme jua biem dokumentacionin komplet, e lexoni vetë. Faleminderit!

Resul Fetahu: E nderuar kryesuese, i nderuar zv.kryesues, i nderuar kryetar, të nderuar drejtorë, të nderuar asambleistë! Gjatë seancës së dytë më janë bërë disa pyetje nga asambleisti Munir Jonuzi në lidhje me Drejtorinë e Administratës. Në Raportin e Punës, ku thuhet në lidhje me

shërbimet e ujësjellësit, e ka pas pyetjen e parë. Shërbimet e furnizimit me ujë të pijes bëjnë pjesë ato që janë nëpër të gjitha institucionet komunale, si në komunë, në DKA, në DKRS, në Shtëpi të Kulturës, të kjo çeshmja këtu te ushtari turk Huesin Kutlu, krejta këto bëhen përmes Drejtorisë së Administratës. Pastaj pyetja tjetër ka qenë, një numër i konsiderueshëm dokumentash, 40-45 mijë, e aty në tabelë ka qenë 31,300, por këtu bëjnë pjesë të gjitha dokumentet që janë lëshuar. 31,300 Zyra e Gjendjes Civilel 181 Aktvdekje; 320 nga Regjistrat Themeltarë; 503 nga Regjistrat e Veçantë nga bota e jashtme; 22 nga lirimi i shtetësisë; 181 nga fitimi i shtetësisë; 17 regjistrime sipas Ligjit për Shtetësinë; 40 shkurorëzime; nga eKosova 12,419. Gjithsej në total bëjnë 44,983. Një pyetje tjetër, numri i të ardhurave është i ulur nga 39 mijë në 36 mijë. Arsyeja pse janë ulur të hyrat është sepse ka hyrë në zbatim më tepër eKosova, dhe tjetra është ndryshimi barrës administrative. Pyetja tjetër është se gjatë vitit 2023 kemi grumbulluar rreth 17 mijë, kurse prapë në Raportin e vitit 2024 është 17 mijë. Mirëpo, në Raportin e vitit 2024 është 14, 578 euro që janë inkasuar. Pyetja tjetër është se përballemi me mungesë të stafit në Zyrën e Prokurimit Publik. Po, kemi mungesë, mirëpo dy zyrtarë i kemi dërguar për trajnim në KRPP. Prokurimi i skanerëve në Zyrën e Pritjes, si në vitin 2023 njësoj edhe këtë vit, nëse janë blerë një apo dy skanerë. Shkruan aty “furnizimi dhe konfigurimi i skanerëve”, dy skanerë janë total. Pastaj është pyetje se a është instaluar fare ai printer dhe ku vendoset, e qytetarët tanë a dinë ta përdorin. Printeri është në Zyrën e Pritjes, përdorimi bëhet vetëm me praninë e zyrtarit. Një pyetje tjetër është, një sugjeri, automjetet tuaja nuk kanë shenja dhe tabela, dhe disa prej tyre kanë rënë, si për shembull Passat 387-shi, po mendoni të futni GPS dhe kjo varet gjithmonë nga burimet financiare. Po! Passat 387-shi është në pronësi të QKMF-së, kurse drejtorët dhe zyrtarët kanë të drejtë të përdorin autmojetet zyrtare, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Vetëm duhet të bëhet kërkesë, të plotësohet blloku, të nënshkruhet nga drejtori i Administratës. E njëjta gjë vlen edhe për vendosjen e kamerave. Momentalisht nuk ka buxhet për GPS dhe për kamera, sepse Kontrata Kolektive e ka dëmtuar Buxhetin komunal. Tjera pyetje nuk ka pas. Faleminderit!

Redzep Ibraimi: E nderuar kryesuese e kuvendit, zëvendës, i nderuar kryetar, të nderuar delegatë. Ju falënderoj për pyetjet dhe interesimin për punën e drejtorisë. Më poshtë po jap përgjigjet për pyetjet e parashtruara: **Furnizimi me energji elektrike për fshatin Trokan:** Fshati Trokan nuk është i lidhur me sistemin elektro-distributiv. Deri në fund të vitit të kaluar janë përfunduar të gjitha punët teknike dhe administrative. Janë vendosur shtyllat prej betoni dhe është blerë kabloja përkatëse. Ka mbetur pjesa e KEDS-it për ta lidhur deponinë me rrjetin elektrik. **Funksionaliteti i peshorës:** Peshorja që është instaluar para dy vitesh është vënë në funksion me ndihmën e një agregati përkatës dhe përdoret për nevoja të kontrollit dhe

monitorimit të deponimit të mbeturinave komunale në baza ditore, mujore dhe vjetore.

Zvogëlimi i pikave të zeza të deponive ilegale: Janë identifikuar mbi 100 lokacione si hap i parë. Për eliminimin e tyre po zbatohet një qasje shumëdimensionale:

- Intensifikimi i mbikëqyrjes komunale,
- Organizimi i aksioneve të pastrimit në bashkëpunim me kompani lokale,
- Forcimi i sanksioneve për deponimin ilegal të mbeturinave,
Paralelisht, po zhvillohen edhe kampanja për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve.

Mungesa e zjarrfikësve: Problemi i mungesës së 8 zjarrfikësve është identifikuar dhe vazhdimisht theksohet në raportet vjetore. Drejtoria ka nisur disa herë procedurat dhe pritet një përgjigje pozitive gjatë këtij viti. Vendimet për punësim merren nga niveli kompetent – Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME), e cila shpall konkurset dhe i kryen procedurat administrative. **Parandalimi i zjarreve të qëllimshme:** Janë ndërmarrë masat preventive si:

- Vëzhgim i shtuar i zonave të rrezikuara (Plavë, Bukë, Brezne),
- Fushata informuese për ngritje të vetëdijes.
Megjithatë, disa zjarre kanë ndodhur, por janë lokalizuar dhe shuar falë reagimit të shpejtë të njësisë zjarrfikëse. **Blerja e mekanizmave:**
Plotësisht pajtohemi se përfshirja e mekanizmave të nevojshëm në buxhetin e vitit të ardhshëm është mënyra më efektive. Propozimi për buxhetin e vitit 2026 pritet t'i përfshijë këto pika dhe presim përkrahje nga Kuvendi për miratim.

Përfshirja e të gjitha fshatrave në sistemin e mbledhjes së mbeturinave:

Në proces është hartimi i një plani gjithëpërfshirës për integrimin gradual të të gjitha fshatrave. Plani përfshin:

- Hartimin e prioriteteve për fshatrat,
- Zgjerimin e logjistikës dhe itinerarit të shërbimit komunal,
- Sigurimin e kontejnerëve dhe pikave të grumbullimit.

Bashkëpunimi me KEK-un dhe KESCO-n: E mbështesim plotësisht nismën për krijimin e një bashkëpunimi më të qëndrueshëm me KEK-un dhe KESCO-n. Bashkëpunimi i drejtorisë sonë bazohet në një trup koordinues të rregullt që zgjidh kërkesat për ndriçim publik.

Blerja e automjeteve për inspektim: Njësia zjarrfikëse aktualisht ka një automjet që përdoret për intervenime operative dhe për inspektime në terren. Drejtoria planifikon, sipas mundësive, të blejë një automjet shtesë që do të përdoret ekskluzivisht për:

- mbikëqyrje,
- kontroll të deponive ilegale,
- monitorim të punëve në terren,
- dhe aktivitete preventive.

Mirëmbajtja e rrugëve – punëtorë shtesë: Po shqyrtojmë mundësinë e angazhimit të punëtorëve sezonalë për mirëmbajtjen e rrugëve në verë dhe dimër, në përputhje me kornizat

ligjore dhe kufizimet buxhetore. Një ndër sfidat është numri i kufizuar i ditëve të lejuara për angazhim të përkohshëm dhe nevoja për mjete shtesë për pajisje dhe trajnim të punëtorëve.

Zeni Krasniqi: I nderuar kryetar, e nderuar kryesuese, zv.kryesues, të nderuar delegatë të Kuvendit dhe ju të pranishëm! Në adresë të DKA-së nga seanca e kaluar janë parashtrur disa pyetje. Do të mundohem që t’u përgjigjem. Nga delegatja e nderuar është bërë pyetja çka po ndodh me çerdhen, kur do të funksionalizohet. Ne kemi bërë kërkesë në Ministrinë e Arsimit, që ta përcjellë komisionin dhe ta shohë gjendjen se si është çerdhja, për funksionalizimin e saj. Ministria na është përgjigj dhe komisionin e ka dërgue këtu, ka ardhë e ka parë objektin. Në një mënyrë jo të drejtpërdrejtë e ka pranue si objekt që i plotëson kushtet, mirëpo na kanë parashtrur disa rekomandime të cilave ne u jemi përgjigjur. Jemi munduar deri në përpikmëri t’u përmbahemi atyre rekomandimeve. Një ndër to ka qenë edhe rrethoja, mirëpo sot e atëherë, deri më tash nuk e kemi marrë pëlqimin. Ata kanë thënë pritni, ne do t’ua kthejmë përgjigjen juve dhe do t’ua japim pëlqimin, mandej ju duhet ta bëni funksionalizimin. Jemi në pritje të komisionit që të na kthejë përgjigje. Pyetja tjetër ishte, Qendra me Bazë në Komunitet, nga qëndrimi teorësh është kthyer në një orë e tridhjetë minuta. Nuk është e vërtetë! Mund të them në njëfarë forme, është e vërtetë vetëm për një periudhë të caktuar, ndoshta ke marrë vesh, se ju pyetjen e bëtë edhe si delegate, po edhe në cilësinë e prindit, se ju e keni fëmijën aty. Ajo ka qenë një periudhë shumë e shkurtë, sepse edukatorja ka qenë për shkaqe shëndetësore – disa ditë, një javë ka mund me ndodhë. Gjithmonë ka qenë tri orë, vetëm se ka kërkuar edukatorja – edhe pse unë jam shumë i kënaqur, me siguri edhe ju jeni për atë - se tha që ka numër shumë të madh të fëmijëve. Ku është ajo kënaqësi shumë e madhe që të kemi fëmijë na. Edhe ajo në njëfarë forme i ka përballue derisa kemi bërë rekrutimin e edukatoreve. Me angazhimin e edukatoreve, është përmirësue, ka vazhduar. Mirëpo, ajo ka qenë një periudhë shumë e shkurtë, një orë e gjysmë – për shkaqe shëndetësore, e ka pas gripin ajo, s’ka mund me qëndruar tri orë. Pyetja tjetër, çfarë aktivitete planifikoni për Javën e Gjelbër nëpër shkolla. Ju e dini se ne i marrim edhe raportet e punës nga drejtoritë e shkollave. Ju e dini se në muajt prill dhe maj është Java e Gjelbërimit. Të gjitha shkollat kanë aktivitete të ndryshme rreth pastrimit të oborreve, mbjelljes së fidaneve të ndryshme, luleve etj. Këtë ne e kemi shti në Planin e Punës të DKA-së, gjelbërimit nëpër shkolla. Pyetjen tjetër nga një delegat e kemi pas, a jeni në dijeni që në Shkollën Filllore “28 Nëntori” që një muaj ditë nuk ka, ka mbet pa dru. I nderum delegat, nuk është e vërtetë. Po të kish mbet shkolla pa dru, me siguri shumë ishte bërë alarmante kjo çështje, me siguri ishte ndërprerë edhe procesi i arsimit. Urdhëroni ju delegatë, edhe jeni banorë

të kësaj Komune, a keni pas ndërprerje të procesit arsimor për shkak të mungesës së druve. Mos harroni se i kemi pas edhe zgjedhjet më 9 shkurt, edhe ka qenë një ditë shumë e gjatë, prej mëngjesit në ora 05:00 e deri në ora 21:00 në mbrëmje, janë harxhues shumë dru. Edhe vitin e kaluar, Shkolla Fillore “Restelica” ka mbet pa dru, kemi marrë dru prej Shkollës “Fetah Sylejmani” i kemi dërgue atje. Por jo ashtu pyetjen qysh e bëre, se një muaj ditë ka mbet shkolla pa dru. Po të ishte pa dru, ishte ndërprerë procesi mësimor. Edhe kjo tjetra - pyetjet kur t’i bëni duhet me pas shumë argumente – pse nuk po jau bëni orët shtesë të gjithë mësimdhënësve, por i keni ndarë në baza politike. Unë që dy vite i bona, deri sot asnjë përjashtim nuk e kam bo. Të gjitha kërkesat që vijnë prej drejtorëve, për kompensimin e orëve shtesë të cilat i mbajnë, deri sot te unë nuk ka ndodhë në baza politike. Pyetja tjerë e një delegati ishte çështja e Doracakut. Ndoshta delegate i nderum ka harrue, se ka kaluar një periudhë dy-tre mujore. Për çështjen e Doracakut, kemi qenë ndër komunat e para që e kemi bërë reagimin. Këtë ta argumentoj: në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të datës 15 nëntor, si pikë e parë e rendit të ditës ka qenë shqyrtimi i Doracakut, për rishikimin, edukimi seksual dhe shëndeti riprodhues, i miratuar në vitin 2020. Menjëherë, nga ai takim ka dalë konkluzioni që DKA-ja ta përgatit vendimin – e keni në faqen e Komunës së Dragashit – menjëherë pas saj ne si DKA kemi përgatit edhe Vendimin – që ku është Vendimi, është i datës 15.11.2024, me numër të protokollit 13/900 – edhe thotë: “Merret vendim lidhur me moszbatimin e doracakëve për mësimdhënës – Edukimi seksual dhe shëndeti riprodhues, i shëndoshë dhe i sigurt – në të gjitha shkollat e Komunës së Dragashit.” Reagimi është bërë me kohë dhe menjëherë e ka tërheq për revidim MASHTI. Një pyetje tjetër ishte që furnizimi me dru për vitin 2024 është bërë vonë, këtë vit a keni planifikue që të bëhet më herët. Unë pikërisht për këtë – transportin e nxënësve dhe furnizimin e shkollave me lëndë djegëse – jam shumë i kujdesshëm. E kemi bërë edhe vitin e kaluar shumë herët, por ju e dini – jau ka dhënë përgjigjen edhe kryetari me një seancë të kaluar – edhe këtë vit do ta bëjmë njëjtë sikurse vitet tjera, kështu që unë gjithmonë e kam planifikue që në shtator shkollat të furnizohen me dru. Ishte edhe një pyetje që edhe unë nuk e kuptova, më duket se ishte që nxënësit po i sulmojnë mësimdhënësit. Ndonjë kërkesë nga drejtorët e shkollave, DKA-ja deri sot nuk e ka pranue. Ka grindje të vogla kështu, fizike, në mes të nxënësve, kurse nxënësi që e ka sulmue ndonjë mësimdhënës, në DKA deri më sot nuk kemi pranue ndonjë informatë. Faleminderit!

Liridona Misinaj: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryetar, e nderuar kryesuese, të nderuar delegatë! Në seancën e kaluar edhe unë, si të gjithë drejtorët e tjerë, kam pranuar disa pyetje. Njëra

prej tyre është: një organizim nga një ngjarje kulturore nga Zaeno za Brod, sa është paguar kjo organizatë. Organizata Zaeno za Brod nuk ka aplikuar vitin e kaluar dhe nuk është mbështetur financiarisht nga Komuna e Dragashit. Në Raportin të cilin unë e kam dorëzuar në Zyrën e Kuvendit – është ky Raport – përkthimi me siguri ndoshta ka shkuar gabim. Sa i përket pyetjes tjetër për Fondin Librar të Bibliotekës Amë, Biblioteka qendrore “Ymridin Qengaj”, në raportin e fundit të cilin ma ka sjellë udhëheqësi i Sektorit të Bibliotekës, për shkak të gjendjes shëndetësore të cilën e ka pasur, momentalisht gjendja dhe fondi i librave të Bibliotekës Amë është 65,811 libra, dhe jo ai i cili është raportuar. Po ashtu, një pyetje tjetër e kam pranuar për organizimin e Ditës së Goranëve dhe të Boshnjakëve. Zakonisht, ne si drejtori bëjmë shpalljen e thirrjeve publike dhe prioritet në ato thirrje është organizimi i Ditës së Goranëve dhe të Boshnjakëve, ku për fat të keq vitin e kaluar nuk kemi pasur asnjë aplikim për këto dy data të rëndësishme. Sidomos për Ditën e Boshnjakëve, kur është ripërsëritur thirrja. Sa i përket pyetjes tjetër se pse këto dy data nuk janë në Plan të Punës, nuk do të thotë se janë më pak të rëndësishme. Ne si drejtori organizojmë edhe shumë aktivitete, nga më të ndryshmet dhe jo më pak të rëndësishme, të cilat nuk janë në Plan të Punës, por janë prioritet për ne si Komunë, si drejtori. Sidomos, promovimi i vlerave dhe i trashëgimisë kulturore në Komunë të Dragashit. Faleminderit!

Qamil Kolloni: Para seancës i kam pas tri pyetje, për afërsisht mendoj se i kemi sqaruar dhe besoj se janë në rregull. Kemi pas një rënie të të hyrave vetanake në tatimin në pronë, mirëpo sipas raportit vjetor të cilin e kemi marrë, megjithatë Planin për të hyrat e kemi realizuar dhe diku 58 mijë euro janë të inkasuara më shumë gjatë këtij viti. Ju e dini se për buxhetin gjithmonë ekziston edhe risku dhe plani i riskut. Sivjet, me Ligjin për Tatimin në Pronë, është paraparë që të përdoret mënyra progresive e llogaritjes së tatimit në pronë, por për arsye subjektive apo probleme tjera, Qeveria e Kosovës nuk ka filluar me aplikimin edhe për këtë vit. Edhe për këtë vit ne mund të kemi, për arsye se kemi planifikuar në Buxhet, një shumë më të madhe të të hyrave, por meqenëse ky ligj nuk është funksional sivjet dhe Qeveria e Kosovës nuk e ka shti në zbatim, kemi mundësi mos me mund me e realizuar planin për aq sa kemi planifikuar të hyra vetanake nga tatimi në pronë, për shkak të këtij ligji, se në këtë ligj është paraparë që në mënyrë progresive të bëhet edhe rritja e vlerës nominale të objekteve dhe objektet të hyjnë në tatimin në pronë, dhe njëkohësisht edhe tokat kanë hy, dhe për çdo vit të shkohet në masën rritëse. Domethënë, kanë mund ta rritin 10% , 5%, varësisht qysh vendos Zyra e Tatimit në Pronë. Mirëpo, besoj se nuk do të kemi shumë rrezik edhe për këtë çështje. Kemi biseduar për disa projekte kapitale, mendoj se i kemi sqaruar disa mjete të

cilat janë paraparë këtë vit. Diçka kështu më të rëndësishme nuk besoj se kemi. Për përqindjen e ndarjes buxhetore, Munir, duhesh me e ditë se është qajo që është, 41.3% me 58.7%. Mendoj se tjerat i kemi diskutue, nuk dua t'ju marr shumë kohë. Ju uroj sukses!

Driton Ademi: Drejtor, është mirë – pasi edhe në pjesën e parë nuk ishte, te pika e pestë, por do t'i kthehem te eventualja, se nuk due me ndërhy te pikat tjera. Nuk është lehtë me dalë me gënjye para popullit, edhe me thënë për një ditë janë harxhit drute, pse ka pas zgjedhje. Nuk e besoj që është e arsyeshme. Ka pas zgjedhje, e keni bo një arsyetim qaty që janë harxhue shkaku i zgjedhjeve. Nuk ka pas dru në shkollën e Bresanës. Punëtori i shkollës, me makinën e vet, ka shkue i ka marrë në shkollën e Blaçit drutë. Këtë nuk jam duke e thënë unë, janë duke e thënë edhe qytetarët të cilët vetë e kanë pa. Unë jam përfaqësues i tyre, po ke edhe qytetarë të cilët e kanë parë. Te pika e dytë, ku thaje emrat, që është duke iu bo pagesa njerëzve të LDK-së. Shumë e vërtetë është. Sot nuk i kam emrat me vete, po në seancën e ardhshme ke me i pas këtu. Megjithëse gjysmë mandati po të bjer ty, domethënë vonë pak, po ke me i pas emrat qetu, që njerëzve tu, jo vetëm pagë shtesë, për orë shtesë, por plus edhe ka dy paga, duke mbajtur mësim edhe atje, edhe atje. Edhe e dish shumë mirë për çfarë rasti jam duke folë. Këto nuk janë as shpifje, as gënjeshtër, janë të dalur prej njerëzve të cilët, edhe marrin pagë shtesë, po janë edhe prej njerëzve të cilët vetë e kanë pa që keni shkue edhe i keni detyrue me shkue me i marrë në shkollën e Blaçit drutë. Faleminderit!

Munir Jonuzi: Jam i kënaqur me përgjigjet, megjithatë ka disa gjëra që më shqetësojnë. Pyetja që kam bërë nuk ka pasur të bëjë me shpërndarjen fairshare të të gjitha projekteve, por nuk kam pasur informacion se si ka qenë me grantin e performancës. 58% kundrejt 41%, besoj se ka qenë ashtu. Nuk më keni përgjigjur në pyetjen e katërt se cilat janë ato projekte. Ajo që më shqetëson, dhe që duhet t'ju shqetësojë edhe juve, është çështja se me çfarë njerëzish po punoni. Çfarë janë drejtorët tuaj, këshilltarët, ndihmësit... Këtu po shqyrtojmë raportin për vitin 2024. Ju thatë se keni angazhuar Televizionin TV Prizreni për dy projekte. Njëra ishte vizita e ambasadorit britanik – ajo ka ndodhur në vitin 2025. Kanë ekzistuar dy vendime, por jo këto dy që i përmendi kryetari. Tani i di këto dy vendime, atëherë nuk i kam ditur. Më keni anashkaluar pyetjen e dhjetë. Nuk më keni dhënë përgjigje për procesverbalet nga takimet publike. Pse drejtorët e këtij ekzekutivi janë të tillë dhe pse sillen në atë mënyrë ndaj qytetarëve? Ushtuesi i detyrës së drejtorit të administratës ka thënë se shërbimet e ujësjellësit i lidhni me çesmen publike pranë përmendores së ushtarit të rënë të KFOR-it turk, si dhe se qytetarët kanë kërkuar të paguajnë shpenzimet e asaj çesme publike. Ju

u përgjigjeni të gjitha kërkesave të qytetarëve – përveç kërkesave të mia. Pse? Ju në atë vendim thoni se për financat është përgjegjës drejtori i financave. Atëherë pse drejtori i administratës thotë se këtë e paguajmë ne? Sa i përket shënimeve në vetura – ai Passati ende nuk ka shenjë. Sa i përket GPS-it, kjo është mirë në mënyrë që të dini ku janë drejtorët dhe zyrtarët tuaj. Drejtori i shërbimeve publike ka dhënë përgjigje të shkëlqyera – nuk kam fjalë. Tani kemi mësuar se për punësimin e tetë zjarrfikësve nuk është faktore komuna, por është kompetencë e agjencisë për menaxhimin e situatave emergjente. Në planin tuaj për vitin 2025 keni paralajmëruar mirëmbajtjen e rrugëve lokale gjatë verës. Ju lus që ta realizoni këtë. Drejtori i financave nuk më është përgjigjur nëse vitin e kaluar kemi pasur vizita nëpër fshatra.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë, vazhdojmë te pika e nëntë, pika e fundit, pika eventuale.

Nexhat Selaj: Po më vjen mirë që drejtorin e Arsimit po e kam më shpesh këtë kohën e fundit dhe po më jepet mundësia ndoshta edhe me debatue, edhe me pranue edhe përgjigje. Pak më parë në fjalimin e vet, u deklarua se edhe pyetjet janë pak bazike, që ta parashtrijmë edhe një pyetje. Drejtor, në bazë të cilit udhëzim administrativ keni bërë transferet e nxënësve nga Prizreni në Shkollën e Mesme “Ruzhdi Berisha”, nga drejtimi Teknologji e Ushqimit në Prizren, i regjistruar në Dragash në drejtimin e Infermierisë. Cilin udhëzim administrativ e ke lexue edhe ku je bazue që ta bësh këtë transfer, kur ne e dimë se për këto shkelje të cilat, sipas juve, janë bërë nga ish-drejtori dhe është marrë një dënim, shkarkimi nga detyra. Këtu, kush jep llogari dhe kush duhet me u shkarkue, sipas juve? Dhe në bazë të këtyre parregullsive të cilat po vazhdojnë të bëhen, me keqardhje them se do t’i humbim edhe 50 nxënës të drejtimit të fushës së Mjekësisë, të Infermierisë, pikërisht edhe të Farmacisë, pasi që me këto lojëra që po bëhen jam shumë i sigurt se nuk do të na lejojë Ministria e Arsimit këtë vit Infermierinë edhe Farmacinë. Dy: Të jeni pak më syçelë –më falni që po ju drejtohem në këtë drejtim – por ne po kemi pasoja gjatë vazhdimit të procesit mësimor, kur po ndodhin pensionimet e punëtorëve gjatë procesit mësimor. Po neglizhohet marrja e punëtorëve tre-katër muaj, të cilët seriozisht po kanosen me probleme. Ne tash rastin e kemi në Shkollën e Mesme “Ruzhdi Berisha”, pensionohen tre-katër profesorë të cilët po kanë normë të plotë të orëve, dhe gjatë këtyre mbetjeve të orëve po na kanosen probleme shumë serioze. Nuk mund të mbulohen ato me profesorët tjerë, të cilët nuk jemi adekuatë që t’i mbajmë ato orë. Kështu që, po na detyrohen pauza të shumta, të cilat po na prishin edhe rregullin brenda shkollës. Mendimi im është që të jesh pak më syçelë, i ke të gjitha të dhënat për pensionimet e punëtorëve, të cilët me kohë t’i rregullosh, mos të në ndodhë sikur vitin që shkoi, por ajo

neglizhencë e juaj dhe e stafit tuaj, ku ne mbetëm tre muaj e gjysmë pa mjekë edhe pa profesorë të Farmacisë. Askush nuk u ndëshkua nga kjo, nee e kaluam një gjysmëvjetor pa dy profesorë bazikë të lëndëve të Mjekësisë. Derisa jemi këtu, u përmend edhe furnizimi me dru, thajë ashtu si në vitin 2023 dhe 2024, do ta kryejmë edhe këtë vit. Jo ishalla kështu s'e kryjsh! Ato probleme të cilat kanë qenë me furnitorin, ato janë probleme të juaja, të ekzekutivit. Problemi është që këtë vit, vitin që shkoi 2024, drutë i ke sjellë, kamioni i parë me lëndë djegëse ka ardhë më 12 dhjetor. Ishalla nuk përsëritet kështu, se falë kushteve klimatike që ka qenë nxehtë, se përndryshe ne shkollën me e mbyllë. Kështu që, ishalla nuk na përsëritet, drejtor. Këto janë fakte bazike të cilat, nëse ke kundërgjegje, unë jam këtu dhe mund të flasim për të gjitha këto. Kryetar, në vitin që shkoi e kam paraqit një shqetësim të ruajtja e pyjeve. Pikërisht për këto kompanitë private të cilat po e marrin pastrimin e pyjeve, dhe nuk po bëhen në mënyrën më të mirë të mundshme, pasi po dëmtohen pyjet. Një prej atyre rasteve – ta kam përmend – pishtat të fshatit Zym, që po bëhet pastrimi, është mjerim. Nuk e di a ke qenë, unë e kam vullnetin e mirë për mbrojtjen e ambientit, pasi që i takoj pak edhe kësaj fushe, bashkërisht me juve, me një ekip nga ekzekutivi, të shkojmë në vendin e ngjarjes. Hiç ma larg, para katër-pesë dite isha, para se me ra kjo borë, isha brenda aty. Nëse nuk të duket ty trishtim, se çfarë është vërë në atë hapësirë. Njëjtë ka vazhduar ai avaz edhe tek pishat e fshatit Shajne, po njëjtë edhe te pishat të Laku i Rapçës këtu poshtë. Por, në fshatin Zym, aty po kalojmë gjithashtu, mund të ndalemi tash, ndoshta është pak borë, mund të ndalemi pas dy-tri dite me shkrirjen e borës, dhe do të shohësh se çfarë tmerri është duke u bërë. Aty kanë kaluar ndoshta 60 vite, ju keni qenë në mesin e atyre të cilët e keni pyllëzuar dhe ky filter, ky pastrim i ajrit, të shkatërrohet në mënyrën masakër, unë nuk e kam idenë kush i mbikëqyr edhe si mbikëqyrën këto. Unë të isha lut, si qytetar i lirë, bashkë a kemi ndikim që t'i ruajmë të paktën këto pyje që na kanë mbetë? Përndryshe, u shkatërruan të tëra. Një pyetje vjen nga komuniteti i fshatit Qollopek – disa herë e kam ngrit këtë çështje, “do të bëhet, do të bëhet..” – ata kanë ardhë me një pyetje tjetër: A do të kryhet sivjet ura, që të na lidhë me pjesën tjetër të fushës, pasi që kemi mbetë të izoluar. Vitin e kaluar e keni përmend aty në investimet, pothuajse i takojnë fshatit Zym, po nuk është se ajo është rrugë rajonale që e lidh krejt Opojën, të Laku i Pulës që quhet, keni deklaruar se është bërë hapja e një kanali – që e di që është bërë – por në çfarë mënyre të dobët është bërë ajo hapje, tash prapë i kemi ujërat e mbledhur aty. Jemi dëshmitarë, edhe ju jeni dëshmitarë, sepse kaloni për çdo ditë përgjatë asaj rrugës. Aty, përposj Liqen, nuk po mundet me e quajt njeri diçka. Pikërisht po bëhet fjalë për këtë kohën e fundit, me këto ngricat, po është rrezik

shumë serioz. Një replikë edhe një shqetësim vjen edhe nga banorët e fshatit Brezne. Disa herë më është kërkuar që ta ngris këtë çështje, nga kompanitë private të cilat bëjnë prerjen e asfaltit dhe nuk mirëmbahen ato, kur dihet se rrugët janë publike dhe janë shtruar me paratë e qeverisjes sonë. Aty bëhen prerjet skajore të asfaltit dhe janë hapur kanale, të cilat pothuajse gati po rrezikojnë shumë seriozisht makinat, e jo këmbësorët. Ata m'i kanë dërgue disa nga fotot, unë nuk kam dashtë që të jem shumë publicitar në këtë drejtim, por më mirë është që të shkojmë në vendin e ngjarjes edhe të shikojmë vetë. Unë aty kam parë vetë, me sytë e mi, aty janë të paktën mbi 500 metër rrugë, në të cilën vetëm me një korsi kalohet, pjesa tjetër është mashtruese, mundesh me ra nëpër ato hendeqet. Faleminderit!

Artan Loshaj: Kryetar, përgjigjen që mora për në rrugën Rrenc-Kapre, edhe për te muri mbrojtës te varrezat, nuk kesh i kënaqur. Vetë ti na ke premtue në këtë seancë, vitin e kaluar, që këtë vit do të ndërtohet muri mbrojtës tek varrezat. Aty është një rrezik serioz – tash edhe unë mos të bëhem shumë, me e marrë telefonin, se një herë e dish mirë ta kam tregue, mos ta bëjmë bajat këtu. Aty seriozisht janë të rrezikuara varrezat e fshatit Rrenc. Përgjigjen e dytë që ma dhaje për te stadioni, prapë nuk më dha kryesuesja replikë. E di që është investim dyvjeçar. Ato punimet që janë bërë, me qato para që janë lëshue këtë vit, ato janë krye. Mbikëqyrësi nuk ka qenë prezent aty. Videot i paje, anësoret janë lëshue thujse pa beton hiç. Muri mbrojtës ka rrëshqit, ka shkue deri thujse te reka. Këtë vit kam kërkuar që këto investimet që do t'i bësh, të jeni më syçelë, ju edhe të gjithë ne, që punimet të shkojnë mirë, se ke premtue që do të ketë cilësi të punimeve me standarde të larta. Pyetja për kryesuesen, edhe për ju kryetar: në seancën e fundit kam kërkuar pikë të rendit të ditës Kërkesën e sindikatës. Dhe keni thënë që do të presim një përgjigje nga MAPL, për Kërkesën e sindikatës së Kuvendit Komunal. Keni qenë gojën plot që në këtë seancë do të jetë në rend dite. Tash e di që arsyetimin e jep kryesuesja edhe ti, që do të presim hala. Deri sa do të presin këta punëtorët shëndetësorë këtë kërkesë, kur ata e kanë pas me rregullore, i kanë marrë këto mëditje, këto shujta, lënda është në gjykatë. Pse po presim me shkue lënda në gjykatë, pse nuk e bëjmë një zgjidhje, me e marrë një vendim edhe ... edhe sa muaj ose sa vite do të presin këta kolegë që janë duke na dëgjuar live atje. Kur do të jetë në rend dite pika e cila keni premtuar vetë që do të jetë për këtë seancë, po nuk e bëtë. Edhe sa seanca do të presin punëtorët shëndetësorë?

Nedžmidin Sejdilar: Do të lutesha që kryetari, kur më përgjigjet herën tjetër, të mos thotë se po e shkatërroj komunitetin. Roli dhe detyra ime është të mbroj popullin që më ka zgjedhur, por të themi se po e shkatërroj komunitetin nuk është aspak e vërtetë. Kam qenë konstruktiv kur janë

marrë vendime në interes të komunitetit shumicë shqiptar. Për shembull, për stadiumin në Bljac që duhej urgjentisht të përfundohej – e kemi votuar me 27 vota, e ende nuk dimë nëse është përfunduar. Përveç zhavorrit dhe rrethojës nuk kam parë gjë tjetër atje dhe nuk e di nëse ka pasur ndonjë përparim në punë. Mos thoni se në komunën tonë nuk ka diskriminim – drejtori juaj nuk u përgjigj për përqindjet kur u pyet pak më parë. E pamë se vetëm 11.000 euro janë ndarë për Gorën dhe kjo është diskriminim i qartë. Sa i përket kësaj fabrike – ju kam dhënë propozimin më të mirë të mundshëm që të presim derisa ajo pikë të futet në rendin e ditës, ta rrëzojmë përfundimisht fabrikën e kromit dhe ta mbyllim përgjithmonë këtë çështje. Ajo që keni bërë sot është që e keni shtyrë atë pikë, por i keni lënë hapësirë që i njëjti propozim me një lokacion tjetër të kthehet në rendin e ditës dhe të tentoni ta shtyni, në dëm të qytetarëve të kësaj komune, pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare. Në këtë vendim unë shoh vetëm një lëvozhgë banane të hedhur për qytetarët – vetëm për të fituar më shumë kohë dhe për ta shtyrë këtë agjendë. Kjo fabrikë është e dëmshme. Sa i përket veturave – keni thënë se do të krijohet një komision që të kontrollojmë ato vetura. Kur do të krijohet ky komision? Kur do t'i shohim ato vetura në qendrën e mjekësisë familjare që nuk janë më të vjetra se tre vjet? Si ka ndodhur që është riparuar një veturë që nuk është më e vjetër se një vit? Si është pranuar një veturë e re me defekt dhe pse nuk është kthyer te furnizuesi si jofunksionale? Çfarë bën ky "Human Care"? Gjatë mandatit tuaj u kemi dhënë atyre rreth 800.000 euro. Cili është konkretisht shërbimi që e kryen kjo organizatë joqeveritare në komunën tonë? A di ndokush se kush janë personat që janë pjesë e kësaj organizate? Kush janë ata njerëz? Ne u kemi dhënë atyre mbi 800.000 euro. Pres të formohet një komision që të na dorëzohet i gjithë dokumentacioni, që të shohim projektet e tyre dhe çfarë bëjnë. Ju thatë se për qytetarët e fshatit Radeš keni kundër-peticion, dhe se banorët e fshatit Radeš lejojnë marrjen e lumit. Unë kërkoj nga ju që këtë dokument ta publikoni dhe ta sillni në kuvend. Ne jemi këtu të deleguar për të mbrojtur interesat e qytetarëve. Nëse keni një dokument të tillë, nxirreni dhe paraqiteni në kuvend dhe realizoni kërkesat që janë në atë dokument. Ju nuk keni qasje të njëjtë ndaj të gjithë qytetarëve. Në fshatin Krushevë vazhdimisht kemi rrëshqitje dheu dhe gurësh. Ju ndoshta nuk jeni kompetent për mirëmbajtjen e rrugës, por jeni kompetent për të kërkuar nga organet përkatëse sanimin e saj. A do ta lejonit një situatë të tillë në vendin tuaj? Kryetari i komunës është udhëheqës i komunës dhe është përgjegjës për të siguruar jetë më të mirë për qytetarët. A është politikisht apo moralisht e drejtë që këshilltarët tuaj, që më parë i keni punësuar në funksione politike, t'i punësoni sërish në funksione profesionale? A është kjo e drejtë? Si do të

reagonit nëse dikush tjetër do ta kishte bërë këtë? Një sjellje e tillë e shoh si kërcënim të hapur. Ju lutem të më mbroshi nga veprime të tilla. Jashtë kësaj sale do të mbrohem vetë. Nga sot e tutje do t'informoj të gjitha institucionet kompetente për sigurinë e pjesëtarëve të komunitetit jo-shumicë. Kjo është kërcënim i hapur dhe frikësim.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Edhe unë nuk e pashë çka është, edhe s'po due edhe me e pa. Por, nuk e lejoj nga askush që ajo të vijë! Vazhdojmë tash me punën e Kuvendit, ju kisha lut kështu mos me bo në Kuvend! Kuvendi është për të gjithë edhe kanë të drejtë ata me Rregullore të flasin edhe të debatojnë.

Munir Jonuzi: Ajo që ndodhi me Sejdilarin nuk është në frymën e demokracisë dhe është sjellje jo e duhur ndaj komuniteteve joshumicë. Ndoshta kjo pasqyron sjelljen tuaj ndaj komuniteteve joshumicë, por që drejtori i financave apo kushdo tjetër të vendosë harta është e papërshtatshme. Ne jemi këtu që të debatojmë me forcën e argumenteve. O kemi, o nuk kemi, por jo të kërcënojmë njëri-tjetrin. Ne jemi këtu për të zhvilluar beteja verbale, jo fizike. Nëse këtu i rrezikojmë njëri-tjetrin, çfarë mbetet për qytetarët tanë? Diskutimi im ka të bëjë me respektimin e të drejtave gjuhësore të komuniteteve joshumicë. Në faqen zyrtare nuk keni të publikuar asnjë tender, kështu që nuk e di nëse i shpallni apo jo. Në faqen e internetit nuk e respektoni Ligjin dhe as Statutin e Komunës. Tre gjuhë zyrtare janë në këtë komunë. Në faqe i keni vetëm kategoritë për shqip, anglisht dhe serbisht. Për gjuhën boshnjake nuk keni. Ju lutem të shtoni një kategori për gjuhën boshnjake – kështu do ta respektoni Statutin e komunës sonë. Është çudi që duhet të reagoj unë pas vizitës së Valdon Bytyqit, i cili është komisioner për gjuhët. Më 27 janar 2025 keni pasur takim dhe askush nuk e ka përmendur mungesën e përdorimit të gjuhës boshnjake në faqen e internetit. Është e rëndësishme që dokumentet të jenë shumëgjuhëshe. Nuk i keni respektuar ata njerëz të cilëve boshnjakishtja është gjuhë amtare.

Arijeta Skeraj: Të lutem, drejtor! Ky është Kuvendi, unë nuk e lejoj një gjë të tillë, jo nga drejtorja por nga askush tjetër. Këtu në Kuvend veç asambleistët kanë të drejtë – edhe të mos degradojnë edhe asambleistët. Unë e pashë edhe mu, si kryesuese, nuk më erdh mirë që e bëre atë, por për çfarë e ke bo, e dish vetë.

Shpetim Hajredini: I nderuar drejtor i Arsimit, të falënderoj për përgjigjet që i dhaje. Çështjen e pyetjes së parë të cilën ta pata parashtrur për atë kurikulën, realisht mu nuk më ka ra ta shoh dhe për atë ta kam parashtrur si pyetje. Po ti më dha përgjigje, që ju keni reaguar, po më duket keni marrë edhe vendim, në bazë të asaj që e pashë atë dokument. Kështu që, ju përgëzoj për këtë dhe

faleminderit për përgjigjen. Tjetra – furnizimi i shkollave me lëndë djegëse – ta pata parashtrur, edhe unë, realisht, nuk kam qenë shumë i interesuar me e ditë datën e saktë se kur ju e keni furnizue shkollën e fshatit tim, të Kukit. Por, unë e di një gjë mirë shumë, që fëmijët e mi sa herë kanë ardhë prej shkollës – nja dy a tri javë, në mos gabofsha, se tek e fundit, unë e kam thënë gjithmonë, po e përsëris prapë edhe një herë: për çdo fjalë unë kam me dhënë llogari para Zotit dhe gjithmonë e kam parasysh, edhe as nuk gënjej, po as nuk mundohem me të qit poshtë, as me të shantazhë e as asgjë, atë që e them, e them me bindje të plotë edhe me argument – dy javë deri në tri, e di saktë, që më ka ardhë edhe djali edhe vajza prej shkollës, kanë qenë të mërdhimë. Qeto e di unë veç. Kur i keni furnizue, ti e dish ma mirë. A qeto unë që po ta them, unë ta them me argumente. Që dësh, ta bie edhe vajzën këtu. Ndërsa, sa i përket tjetrës për sulmin fizik që ta kam parashtrur, edhe këtë e kam me argumente, se edhe këtë e kam dëgjue prej fëmijëve që kanë ardhë më kanë tregue, më kanë thënë e sulmoi filan arsimtarin ky nxënës, i ra shuplakë. Ndryshe unë s'e di çka ka ndodhë. Pastaj, drejtori a merr masa, a vjen te ti edhe i bjer këto informacione, ato parregullsi, ajo është çështje tjetër, ajo mu nuk më intereson edhe nuk i hyj asaj çështjeje. Kjo është detyrë e jotja, ti me e ditë çka është duke ndodhë nëpër shkolla, e jo unë. Edhe një pyetje, i nderuar kryetar. Pagesën e ndriçimit publik e potencove. Po, për disa fshatra keni fillue, për fshatin Kuk e keni marrë përsipër dhe kryhet tashmë nga ana e Komunës. Por, një ankesë e kam nga fshati Zgatar, edhe një pjesë e fshatit Blaç ishin që nuk e keni marrë përsipër pagesën. Për shkak të një problemi që ata kishin, të dy fshatrat – fshati Blaç, një mahallë më lajmëruan që e kanë me orë dhe keni fillue atyre t'ua kryeni pagesën, por po më duket, në bazë të këtij, tha dy mahallëve tjera jo, për shkak se e paskan të lidhur direkt nëpër orë të shtëpive, nuk e kanë me një orëmatës. Një prej kriterëve të Komunës ka qenë që të jetë me një orëmatës komplet ndriçimi publik i atij fshati. Këta një gjë të tillë nuk e kishin, të Zgatarit po njëjtin problem e kanë. Edhe pse Zgatarit – e pashë, ma dërguan – kanë bo njëfarë kërkesë tek ju. Ish kthye menjëherë të nesërmit përgjigjja, që duhet t'i kryeni këto dy kriterë të cilat i keni vendos ju. Ajo që deshta të them, kryetar, ata mjaft kanë pague, ata janë taksapagues të kësaj Komune. T'u kisha lut, e ke mundësinë përmes Zyrës së Prokurimit, hape një tender dhe bonja lidhjen. Komuna le t'ua kryejë lidhje atyre dhe ta marrë më përsipër Komuna edhe pagesën e ndriçimit të këtyre fshatrave. Dhe një pyetje tjetër, po edhe ta kisha dhënë si propozim, ndoshta e ke edhe vetë parasysh këtë problematikë. Çështjen e hapjes së varrezave. Kryetar, unë në fshatin tim mundohem në maksimum me marrë pjesë në hapjen dhe përgatitjen e varrit. Por, kohët e fundit ka fillue me pas problem. Kur ka problem në Kuk, besoj që kanë problem edhe nëpër fshatra tjerë,

e sidomos nëpër këto fshatra që janë pak ma më pak banorë. A kemi mundësi alternative, përmes Komunës apo ndonjë kompanie, që ta marrë përsipër dhe ta bëjë hapjen e varrezave nëpër tërë fshatrat e Komunës sonë, apo opsioni është i pamundur? Edhe pse, e mora një informacion dje, nga daja im Valoni, ai punon tash në Prizren, tha që Prizreni e ka një opsion të tillë edhe po e bëjshin nëpërmjet Ekoregjionit. Qysh e kanë kontratën atje, mu nuk më intereso, nuk vazhdo, por nëse e kanë ata në Prizren, edhe ne e kemi opsionin dhe mundësinë me e bo një gjë të tillë. Ju faleminderit!

Uran Halimi: Më ka mbet borxh te Samidini, që ma herët i tha z.Jonuzi që PDK-ja juve ju ka mbajtur për interes, edhe deshta me e pyet z.Xheladini, z.Samidin në këtë rast, për çka jeni duke i mbajtur ju të JGP-së, e tradhtuat LVV-në, e dish që ne kemi qenë vendimtarë që ju me qenë në pushtet. Pse ju po i mbani ata, atëherë? Çka ju lidh me ta, JGP-në në pushtet, e keni tradhtue LVV-në. Mundesh me m'u përgjigj kur të t'vjen rendi. Një pyetje, kryetar, deshta me të bo, cilët zyrtarë i keni dërgue për trajnim në Zyrë të Prokurimit? A ka mundësi me ma kallxue emrin, kush nga zyrtarët janë dërguar në trajnim, për me u punësue në Zyrë të Prokurimit? Mandej, një pyetje ia kisha bo edhe drejtorit të DKA-së, munden me m'u përgjigj kur të dojë. A ka mundësi me ma kallxue numrin e kurirëve edhe mirëmbajtësve në shkollën e Blaçit? Sa është numri i kurirëve edhe mirëmbajtësve në shkollën e Blaçit? Mu më kanë dalë nja tetë, duke përfshirë edhe paralelet e Zaplluxhes edhe të Zgatarit. Ka bon vaki edhe ma shumë. Te furnizimi me lëndë djegëse, përveç se që është vonue furnizimi me lëndë djegëse, i nderum drejtor i DKA-së, edhe drutë në shkollën e fshatit Blaç kanë qëndruar në rrugë të mbulume me borë, se i ka zënë bora pa i shti brenda, bon vaki deri në janar, e ma vonë se në janar. Edhe e dish ti me dru të lagta se çfarë ngrohje i ofrosh nxënësit, e sidomos atyre nxënësve që janë në mosha shumë të vogla, 5-6-7 vjet. Tjetra, u përmend edhe stadiumi i fshatit Blaç, është e vërtetë se ne me Sejdilarin kemi qenë edhe e kemi vizitue. Pa u përfundue stadiumi, komplet rrethoja është duke lëvizë edhe munden me t'u shemb aty, kryetar. Po, nëse vijsh kah Blaçi, shkojmë e kqyrim edhe bashkë, e kqyrim a po rrejmë a s'po rrejmë. Kur ka me u përfundue ky projekt, çka u bo me atë projektin e fshatit Blaç. Ka pas polemika atë kohën, që VV-ja s'ka me e votue, s'ka me e mbështet. Ne e mbështetëm me 27 vota pro. Çka ka me ndodhë, çka është paraparë, se s'po e dimë tash a ka me u krye, a ka me mbet qashtu. Mandej, te drenazha e stadiumit, komplet të reshurat atmosferike dalin në rrugë aty. E dini që në dy anët stadiumi është i rrethuar me rrugë, edhe gjatë të reshurave, z.kryetar, komplet uji del në rrugë, si nga ana e djathtë nga Mahalla e Epërme. Mirëpo, më e rëndësishmja është që drenazhi në anën

kah Zaplluxhja del në rrugë edhe shkon e futet në varrezat e fshatit Blaç. Bash në varrezat e Mahallës Prifte. I kemi bo publike edhe disa foto, në fakt kryesia e fshatit Blaç i ka shpërndarë disa foto. Ai uji i të reshurave është duke vazhduar me u fut në varreza. Edhe, varrimet së fundmi që i patëm aty, varrezat e sapohapura po mbushen me ujë edhe po është problem gjatë ceremonisë së varrimit. A keni qenë ndonjëherë me e vizitue Mahallën e Epërme, kryetar, me e pa gjendjen e rrugës në Mahallën e Epërme në Blaç, kur është fshati që LDK-ja i ka fitue zgjedhjet aty. Unë po besoj që e meritojnë atë me u vizitue edhe me e pa gjendjen e rrugës, prej rrugës kryesore e deri brenda në Mahallën e Epërme. Mandej, po due me të pyet kur kanë me fillue me u zbatue projektet e parapara për fshatin Blaç. E kemi rrugën te Ura e Haxhisë atje poshtë. Janë në buxhet që janë paraparë edhe janë ndarë për ato. E kemi rregullimin e ujëmbledhësve të famshëm, prej kërkesës së vetme të Kryesisë së fshatit Blaç. Mandej e kemi edhe atë pjesën te Mahalla Prifte, që e keni paraparë me e ndërtue një park në rrugën “Shkëndija”, aty te market “Kroni”. Në ndërkohë, e përmende edhe thaje që akuzat e Filizit edhe të Dukagjinit janë të pabaza, edhe AKK-ja edhe Këshilli ju ka kthye përgjigje. A ke mundësi me m’i dhënë qato përgjigjet, i nderumi kryetar. A mundish me m’i dhënë mu, unë po i kërkoj, nëse mundesh me m’i dhënë. Okej, a bën me i pa? Në rregull. E mban në mend shumë mirë, besoj që edhe ju, kur u patëm takue para Komunës, një traktor të ri e pate ble. Thaje qe, se po folish, qe e bleva edhe një traktor të ri. Mu m’u bo qefi që e blemë një traktor të ri. Mirpëo, me atë traktorin e ri, kryetar, ti veç ia ke lehtësue punën Human Care-it. Po ju japish asete të Komunës një OJQ-së, po i blesh me pare të qytetarëve, po ia japish OJQ-së, edhe 200 mijë euro shpërblim, edhe 20 traktorista, edhe rrugët e pahapura. Tjetra, ndriçimi në fshatin Blaç – shumë mirë, Shpetim, që e përmende, ma rikujtove edhe mu – është e vërtetë që në Mahallaën Prifte dhe në Mahallën e Poshtme, dritat janë të vendosura në ora të familjarëve. Secila familje ka marrë përsipër me e lidhë me numëruesin elektrik të veten. Ka raste edhe prej atyre familjeve që janë shpërngulë edhe s’janë në Blaç, edhe ai s’un e lë dritën dhezur, se po duhet ditë e natë me e mbajt dhezur. Është mirë, kryetar, me intervenue, me i lidhë më një rrjet ose me një orë. Përderisa qytetari, lë që kemi investue edhe i kemi pague në blemjen e atyre dritave, po vazhdon edhe po pagun për ndriçimin ose për mbajtjen aktive të atyre dritave. Kur do ta merrni një hap dhe kur ka me fillue me u zbatue, që me u lidhë secila dritë me një orë, ku pagesën do ta bëjmë ne, ose ju si ekzekutiv. E kam një pyetje nga mësuesit e Gjimnazit, i nderumi drejtor i DKA-së. Thanë që pyete drejtorin e DKA-së kur ka me fillue mbajtja e trajnimeve për kurrikulë. Është kusht i secilit arsimtar që me e pas trajnimin e kurrikulës për me u punësue në institucione të

arsimit. Trajnimi – po thotë – duhet të organizohet nga Komuna, saktësisht nga DKA-ja. Qe tri vjet nuk mbahet ky trajnim në Komunën tonë. Është trajnim bazik, i domosdoshëm për mësimdhënës, ku mbi 20 mësimdhënës të ri jemi në pritje. A mundesh me jau bo një zgjidhje, meqenëse qenka punë e juaja adekuate, a mundesh me e dhënë një afat, ose të paktën kur keni me nis me u angazhues që këtyre mësimdhënësve me ua dhënë këtë trajnimin, ku në secilin konkurs kërkohet me e pas kurrikulën. Këto janë pyetjet e mia. Faleminderit për durimin edhe për dëgjimin!

Samidin Xheladini: Driton, mirë është që po e luan rolin e prokurorit, e të gjykatësit hetues, por po ta bëj një rikujtim. S’po i dish ligjet, shkollat kanë të drejtë – kam të drejtë me të dhënë unë përgjigje, se ke folë për shkollën e Bresanës edhe të Blaçit. Shkollat kanë të drejtë, drejtori ka të drejtë me çue dru ku të dojë. MASHTI i menaxhon krejt nevojat. Po ta rikujtoj një send. Një drejtor i juaji i famshëm edhe një kryetar i famshëm, drutë ose thëngjillin – një shleper – e kanë çue në fabrikë, edhe shkolla e Blaçit me muaj të tërë nuk ka pas nxemje. Edhe nxënësit nuk kanë mbajtur mësim. Po po, Salim Jenuzi, edhe Hajri Ramadani ka qenë drejtor. Qetu në Asamble u debatue. I është dhënë organizatës private thëngjilli, një shleper me dy kamiona, edhe ka qenë thëngjill i pastruar me ujë. I është dhënë, e di Arijeta, e dinë ata që kanë qenë atëherë. Ta dini, ju të PDK-së jeni specialistë për atë punë. E dyta, Urani, m’u drejtue mu për koalicionet. Unë koalicionet, Uran, veç i kam mbështet. E mbështes LDK-në çdo veprim që e merr. Unë u sugjeroj partiakëve të mi, edhe kryetarit, edhe njerëzve të mi, se bëjnë gabime në qoftë se e bëjnë qat veprim, ose bëjnë mirë në qoftë se e bëjnë qet veprim. Por, në të shumtën e rasteve nuk më ngojnë mu. Edhe iu del keq. Pikërisht edhe me ty na ka dalë keq, se të kemi zgjedhë kryesues, e ti s’po e votojsh Ujësjiellësin, s’po e votojsh Buxhetin. Të kam thënë, reflekto, zotëri i nderuar, se kanë me të rrëzue, kanë me të hek. S’më ke ngue mu, të kam thënë, reflekto, se ti je kryesues. Ti e ke përpilue rendin e ditës me e pru këtu, me gjithë kryetarin, edhe ti qat rendin e ditës e ke votue kundër. Është shkelje e rëndë, o Uran. Po më vjen keq, kam respekt, po ti këto dispozitat ka qenë dashtë me i mësue. Nejse, në fillim nuk ke ditë, por unë të kam sugjerue, të kam këshillue ma shumë se çdokënd tjetër, që mos me bo gabime. Edhe koalicionin, unë sa e di, ti e dish ma mirë nashta, edhe kryetari, koalicionin e keni prish ju. Për dikënd tjetër. Qysh e di unë. Se keni dashtë me krjiue favore për dikënd, se ju jeni shumë xhëntelmena, edhe me ia imponue qeverisë se ju duhet me e bo qeto, edhe qeto, për minoritetet demok, se ju shumë parlamentarë. A e pajë Albinin tënd, me atë që fole ti kundër, që thaje me atë Adem Hoxhën e famshëm, “babën” tënd, me Adem Hoxhën a e pajë aty në takim? Pse po flitni, kur atë që e pështyni edhe e lëpini? Adem Hoxhën, po. E na as nuk e pështymë, as

nuk e lëpijmë. Ju edhe po e pështyni, edhe po e lëpini. Mos, kujdes! LDK-ja është parti shumë serioze, veprimet që i bën, i bën shumë të matura. Të tjerët e rrënojnë LDK-në, po LDK-ja nuk ju jep mundësi, argument nuk ju jep për me rrënuë. Atëherë po, të gjithë janë kundër. Edhe ju, Uran, tash po shkoni e po e thirrni Abdixhikun, hajde me bo koalicion. Po pse po e thirrni, bre Uran? Faleminderit!

Driton Ademi: Sapo më erdhi një informatë, jo veç në Blaç, po edhe në Pllavë paskan marrë, Samidin, si mos të je në dijeni. Kështu që, unë veç e pyeta a ke marrë. Qekaq, s'ke pas nevojë për me diskutue ma gjatë. Një pyetje e kam për kryetarin. Kryetar, shumë herë e kemi diskutue edhe privatisht, po edhe këtu, pjesën e kanalizimit te Rruga e Dëshmorëve 1912. A do të ketë ndonjë farë zgjidhje këtë vit, me mundësi prej Grantit të Performancës? Rruga për Blaç, ma shkurt me të thënë, që është kanalizimi goxha i zënë edhe goxha... ne që e dimë, e dimë qysh është i rregulluar, ata që s'e dinë pak ma thellë, ka nevojë për investime. Tash mundesh edhe me m'çue, s'është problem, i çojsh qytetarët, e mu jo. Drejtor, po më vjen keq parëz që s'ke, te pika e pestë, po qetu mu më thanë ka ndryshue Udhëzimi Administrativ i MASHTI-t. Te pika e pestë, po due edhe një herë me e diskutue, se veç e kaluan, po shpresoj mos me u kthye kjo pika e pestë, ky formimi i komisionit. Qetu në fund keni shkruë: "Komisioni përzgjedhës është Ad Hoc dhe mandati i tij përfundon me nxjerrjen e vendimeve përfundimtare për zgjedhjen e kandidatit për pozitën e kërkuar në këtë konkurs". Për drejtorët është pyetja. Unë, Udhëzimin Administrativ e kërkova edhe një herë në telefon, edhe një herë e kqyra, edhe qetu Udhëzimi Administrativ po thotë që ka një vit mandat. Domethënë vit shkollor, 1 shtator – 31 gusht. Nuk munden me e zgjedhë një komision – megjithëse kryetari pak a shumë e dha një përgjigje, por për mendimin tem, qajo përgjigje nuk po bazohet me Udhëzimin Administrativ këtu. Qeky Komision duhet me pas afat deri më 31 gusht dhe nuk munden me qenë ma vonë se 31 gusht. Kryetari e dha një arsytim, për shkak se zyrtari i MASHTI-t nuk po munden me mbërri. Nashta munden me qenë edhe e vërtetë, është edhe e besueshme, por për mendimin tem, qeshtu duhet me qenë. Qet pjesën ku e keni "...është Ad Hoc...", në Udhëzim Administrativ, unë qetu e kam, nuk e kam pa. Paska dalë i ri, po unë nuk munda me e gjet. Rregullore? Nuk e kam pa unë. Drejtor, edhe një pyetje – megjithëse edhe kryetarit po i bjer kjo pyetje – ka fillue me u demolue shkolla e vjetër te "Vetëshërbimi" ne qysh i thona, te pjesa e Domit. Aty ka pas karrika të reja, banka të reja. Dyert edhe dritaret ishin hek, karrikat edhe bankat janë hek, karrikat edhe bankat janë demolue. Druni nuk e di ku ka shkue, e hekrat që kanë mbet prej tyre janë shit, edhe të karrikave, edhe të bankave. Edhe dyert, edhe

dritaret. A ka mundësi me e ditë, kush i ka shit, ku janë shit, edhe a ka mundësi me e ditë, me e pru – sot e di që nashta s'ke në dorë – po në seancën e ardhshme, me e pru qat shitjen, ne me e ditë sa është shuma e qatyne. Edhe, nëse kanë qenë bankat e reja - siç po thuhet prej qytetarëve, edhe karrikat - a ban me e ditë, pse bankat edhe karrikat e reja me u prish edhe me u shit? Faleminderit!

Uran Halimi: I nderumi Samidin, të kam respektue vazhdimisht për shkak të moshës, ti e dish, ke qenë problemi i kësaj Asambleje gjithmonë, po unë të kam amnistue edhe kur ke folë në temë, e jashtë temës. Prapë se prapë iu kam thonë këtyre, ej, po e kuptojmë bre kapak, se Samidini është temperament, po prapë se prapë i lezetshëm. I nderumi Samidin, unë po ndërlihem te ajo seanca kur thaja baba juaj, për babën Albinin. Sidoqoftë, masnej, prej kësaj dole në personale, thaje më kanë thënë njerëzit që ti je djalë i keq – ku po e di çka me ke thanë, kam harrue. Sidoqoftë, foltorja me u shfrytëzue për me hi në personale. A jam djalë i marë a djalë i keq, mu qytetari më ka pru këtu. Krejt i keq me qenë, ti duhet me i respektue ata qytetarët që më kanë mbështet vazhdimisht. Tash unë nuk mundem me të thënë je burrë i keq, unë prapë se prapë po të them që je i lezetshëm. Mirëpo, unë pres reflektim nga ana jote, qetash besoj që je flladit këhtu, brenda. Z.Samidin, besoj që tash je flladit pak brenda the të kanë shkue emocionet. Është konë shumë e ndershme edhe e burrave me dalë me kërkue falje, se unë në raport me ty kurrë djalë i keq s'jem konë. Po ti më ke thënë, bile ti thaje që i ke thënë edhe kryetarit, mos këtë, se ky është ashtu, ky është ashtu. Okej, po është mirë me kërkue falje, se kur të futesh në personale, Samidin, gjithmonë gabosh. Ne s'jemi këtu për personale, këtu jemi për me e bo politikën. Te pjesa tjerër, a po bëhet qeveria, a s'po bëhet, te ftesa Albini që ia ka bo Lumirit, baba djemtë i thirrë sa herë të dojë, Samidin. Ata duhet me shkue, pa qare. Ti vetë ke thënë që është baba ai. Faleminderit shumë!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Besoj që janë krye diskutimet. Atëherë, e kisha lut kryetarin e Komunës që ma shkurtë le t'i bjerë, për arsye se nuk kemi edhe kuorum, po për me e mbyllë, për ata që nuk janë, me iu përgjigj në seancën tjetër.

Bexhet Xheladini: Atëherë, të nderuar asambleistë, unë do të mundohem me ju përgjigj thujse 90% të pyetjeve. Disa që nuk i di, do t'i lëmë për në seancën e e ardhshme. Nexhat Selaj pyeti për transferrin e një nxënësi që është bërë nga Prizreni, që ka ardhë në Infermieri. Për këtë, në seancën e ardhshme, bazën ligjore qysh është bo transferi, e bën drejtori dhe ta bjer me shkrim. Ekziston një bazë ligjore – edhe mu nuk më ka pëlqye ajo – po ish ligjore, çka me i bo. Ajo do të na dëmtojë krejtve, po megjithatë, diçka që është ligjore s'mundim me thënë që nuk bën. Në fillim të vitit të ardhshëm do ta biem ne një vendim, si Komunë, që do ta parandalojmë me u përsërit kjo punë.

Tash a do të ketë sukses a jo – megjithatë, mua nuk më ka pëlqye kjo mënyrë, sepse na bën dëme edhe te personat, edhe te nxënësit, na bën dëme edhe te procesi mësimor. Te pranimit i punëtorëve, që po neglizhohen, ju e dini që me konkurset kemi çdoherë probleme. Kur është fjala te këta që po pensionohen, është krejt në rregull, po i qesim konkurset me rregull. Mirëpo, ka raste kur personat po e lënë punën pa paralajmërim, ose po sëmuren. Gjithashtu, kur po shpallet konkursi, tash ka fillue me u ndie edhe mungesa e profesioneve. E shpallish konkursin, paraqiten persona të cilët dojnë me u punësue me 180 ETC, edhe tash po duhet me u përsërit konkursi. Kështu që këto vonesa, është mirë që drejtori në të ardhmen me u mundue sa më shumë me i zvogëlue, sepse procesi mësimor po dëmtohet. Për pyjet, ju e dini se që një vit nuk i kemi në menaxhim ne si Komunë pyjet. Në menaxhim i ka marrë Ministria e Pylltarisë, edhe ne më nuk kemi kurrfarë kompetenca, na e kanë marrë edhe buxhetin, na i kanë marrë edhe punëtorët, edhe menaxhimin. Mirëpo, ne si qytetarë, tis i qytetar, unë si kryetar, ne mund me e bo një reagim, me kërkue nga Ministria që me pas kujdes. Përndryshe, kompetenca ne si Komunë nuk kemi. Ura te Qollopeku kryhet si të çelet koha, do të kryhet përfundimisht. Kam qenë para dhjetë ditëve e kam vizitue, 95% të punimeve janë krye, po kanë mbet edhe disa punë. Mjetet ekzistojnë. Tek uji mbitokësor, ne vitin e kaluar kemi bërë një investim për kanalizimin fekal. Tash është bërë problem edhe uji atmosferik, është zënë ajo puseta. Kanë qenë zjarrfikësit me e çelë, nuk kanë pas sukses. Si të rregullohet koha, ne do ta rregullojmë atë, edhe pse nuk është kompetencë ekskluzive e jona. Artan Loshaj ka bo pyetje për murin mbrojtës në Rrenc. Unë të tregova, atë do të bëjmë me buxhetin e vitit 2026. Te rruga e stadionit, edhe për atë ia dhashë përgjigjen, por prapë nuk ishte i kënaqur. Unë po i them edhe një herë, ai është projekt dyvjeçar, punimet nuk kanë përfundue, ai projekt nuk është pranuar nga komisioni. Kështu që, çdo gjë që nuk është në rregull, komisioni ka me e detyrue me kthye në gjendje normale edhe punimet kanë me u krye sipas projektit që është shpallë në tender. Sa i përket kërkesës së sindikatës për shëndetësi, ne bashkë me kryesuesen kemi bisedue me kryetarin e sindikatës së shëndetësisë, edhe jemi marrë vesh, edhe kemi marrë lejen prej tij që kjo kërkesë do të procedohet në Asamble pasi të na vjen ligjshmëria nga Ministria. Nëse vjen përgjigja pozitive, ne do ta qesim në Asamble për miratim, sikurse kërkesën e Administratës. Mirëpo, ata na thanë që e kemi edhe një problem, sepse shëndetësië qenka në gjykatë. Kështu që, edhe pa u përfundue procesi gjyqësor, ne nuk kemi ndoshta të drejtë edhe me e qit këtu. Nëse do për këtë pyetje me më plotësue mu kryesuesja, pasi ta përfundoj, munden me folë. Sa u përket pyetjeve të Nedžmidin Sejdlarit, unë kam shumë dëshirë me krijue raporte shumë miqësore me

Nedžmidinin, mirëpo nuk është mirë, mu nuk po më pëlqen që çdo herë kjo foltore po përdoret për nxitje të urrejtjes, ndasisë, te të tri komunitetet që ekzistojnë këtu. Unë kisha pas dëshirë që me Nedžmidinin ta kem edhe një takim në zyrën time, të pimë kafe bashkë, të bisedojmë në mënyrë vëllazërore, edhe unë jam jashtëzakonisht i interesuar që, raportet që i kanë krijuar edhe qeveritë e kaluara, edhe unë, të mos prishen. Unë jam një kryetar i cili dua të formoj dhe dua të ndërtoj ura miqësie në mes të tri komuniteteve që ekzistojnë. M'u bo edhe një pyetje për stadiumin në Blaç, është përgatit projekti, së shpejti shpallet tenderi, edhe stadioni i Blaçit do të përfundojë. U përmend prapë fabrika e kromit. Ne e përfunduam këtë, u mor një vendim këtu që nuk u fut në rend të ditës. Premtimi im edhe i kryesueses ndaj qytetarëve ka qenë që të mos futet, u bë ashtu, u bë mirë. Me sa e di unë, ishte një konsensus, gati të gjithë votuan për këtë. Unë i garantoj – jo vetëm qytetarët e fshatit Shajne, po të gjithë qytetarët e pjesës së Opojës dhe pjesës së Gorës – që unë nuk do të lejoj asnjë investim i cili e dëmton, sidomos shëndetin e popullatës, dhe asnjë investim nuk do të bëjmë pa e marrë miratimin popullatës lokale. Kështu që, nëse popullata lokale është kundër një investimi, ne nuk do ta bëjmë atë. Qëllimi ynë është që të hapim vende të reja të punës, ta ndalim shpërnguljen, ta ndalim mbylljen e paraleleve të ndara të shkollave, të mos na ikin edhe nxënësit. Qëllimi ynë është i mirë, por jo qëllim me çdo kusht me e dëmtue shëndetin e popullatës. Po përmendet shumë shpesh puna e disa automjeteve në QKMF, edhe shumë shpesh po keqpërdoret njëfarë lloj automjeti – 40 km, 20 km, e s' di çka – unë nuk e di çka është fjala. Po e kisha lut edhe një herë Nedžmidinin, le të vjen në zyrë, e bisedojmë, jam i interesuar me e zbardhë këtë problem. Mirëpo, na kur kemi dashtë këtë problem me e zgjidhë, me e zbardhë, jemi përgatit, ju si Asamble, edhe ju Nedžmidin nuk keni dashtë me dalë me i pa automjetet të cilat janë të gjitha në gjendje të rregullt. Po megjithatë, nëse ka diçka, e formojmë edhe komisionin, e shohim edhe një herë e përgjithmonë më mos me bo propagandë për këtë. Nëse është e vërtetë, le të dalë e vërtetë, po nëse është propagandë, më mos e përsërit. Qe tri vjet je duke e përsërit këtë problem. Pse nuk i je përgjigj qytetarëve të Radeshës: Unë të thashë edhe një herë, kam me ta dhënë me e pa marrëveshjen që e ka bo qeverisja e kaluar – më duket Salim Jenuzi ka qenë kryetar atëherë – me qytetarët e Radeshës. Ata e kanë dhënë pëlqimin, e shohish, e lexosh, megjithëse disa njerëz këtu në Komunë kanë dashtë me e hup, e kanë hup atë me qëllime të caktuara. Ne mezi e kemi gjet, na ka gjet një person i cili na ka thënë se kanë kërkue nga ai me e hup, me ia hup gjurmët – ndoshta je një prej atyre ti, se ma së shumti ke bo zhurmë për këtë petitionin ti, edhe ka mundësi që je i përzier edhe ti këtu - mirëpo ne atë dokument e kemi gjet, edhe është, ekziston edhe mundesh

me ardhë me e pa, unë e kam në zyrë. Te rruga në drejtim të Krushevës, prapë këtu deshte me e bo një ndasi – jo në Opojë ti intervenosh, e kur është fjala për pjesën e Gorës, nuk intervenosh – nuk është e vërtetë. Rruga është rrugë nacionale, regjionale, nuk është kompetencë të Komunës, po megjithatë ne në Bord të Drejtorëve kemi diskutue për këtë çështje, kemi dashtë me marrë disa vendime, mirëpo na është thënë nga Ministria se ajo këtë vit ka ndarë mbi 1.5 milionë euro ose më shumë, për rehabilitimin e rrugës Dragash – Restelicë. Dhe, pjesë e këtij rehabilitimi do të jenë edhe ato orteqet që po bien në atë rrugë. Kështu që, ne edhe ashtu nuk kemi të drejtë me investue në atë rrugë, po megjithatë, nuk kemi edhe mjete. Për këto tri punësimet që është bërë shumë zhurmë, duke filluar edhe nga Asambleja, edhe nga Filiz Mustafa prej nivelit qendror, na jemi akuzuar se e kemi shkelë ligjin. E kemi marrë dokumentacionin – e pa edhe Urani dokumentacionin nga organet qendrore, që nuk e kemi shkelë ligjin. E tash, moralisht, a kemi pas të drejtë a jo, ne në konkurs kërkujt nuk kemi të drejtë me ia mohue të drejtën e konkurrimit. Ne i kemi shpallur konkurset, ata kanë konkurrue, janë zbatuar të gjitha normat edhe rregullat ligjore, janë pranuar në punë. Janë ankuar, bile edhe deputetë të Parlamentit të Kosovës, dy deputetë, mirëpo kanë ardhë përgjigjet nga KPMSHC edhe nga Agjencioni Kundër Korrupsionit, që ne nuk e kemi shkelë ligjin. Munir Jonuzi pyeti për barazinë e gjuhëve. Ne, në bazë të informacioneve që kemi, jemi komuna më e mirë në Kosovë, sa i përket zbatimit të dygjuhësisë. Mirëpo, sa i përket asaj dy gjuhë, e tri gjuhë, ne do të shqyrtojmë këtë çështje, do ta shohim. E di që me Statut të Komunës tri gjuhë janë të barabarta, ose katër gjuhë – edhe anglishtja – por do ta shohim mundësinë qysh mujm me e rregullue këtë çështje, se unë nuk jam kundër kësaj. U tha se jeni duke hapur tenderë. Po, jemi duke hapur tenderë për çdo ditë nga pak. Kemi probleme me Zyrën e Prokurimit, sepse shefi i Zyrës së Prokurimit para dy-tre muajve ka dhënë dorëheqje nga pozita e shefit. Unë dy muaj ditë kam humbur kohë duke dashtë me e bind atë me u tërheq, ai nuk është tërheq, e ka lënë edhe punën, mirëpo unë kam insistue edhe nuk kam lejue që ai të largohet nga puna, e kemi sistemue në një vend tjetër të punës në Drejtoratin e Urbanizmit. Tash U.D. i shefit të Prokurimit është Fadil Sinani, dhe aty momentalisht janë vetëm dy zyrtarë duke punuar. Po punohet me një intensitet pak më të vogël, edhe pse Zyra e Prokurimit ka nevojë edhe për ma shumë se dy, ka nevojë edhe për katër, por ashtu janë mundësitë, tash nuk po mujm me i zgjidhë të gjitha problemet menjëherë. Për furnizimin me dru u bë shumë propagandë. Ne në fillim të vitit shkollor e kemi bërë një komision, ka qenë vetë drejtori, nënkryetari i Komunës, i kanë vizitue disa shkolla edhe kemi pas stoqe të mjaftueshme të druve në të gjitha shkollat, edhe të komunitetit

joshumicë, edhe në Opojë, për me e qit dimrin, sepse kemi pas dru nga viti i kaluar. I kanë qit edhe fotografitë, i keni parë në Facebook, edhe asnjë shkollë nuk e ka ndërprerë procesin mësimor për shkak të mungesës së druve. Përveç një ditë, shkolla e Dragashit që e ka ndërprerë mësimin, edhe aty u bë shumë mediatike kjo punë. Por, nuk e ka ndërprerë se s'ka pas dru, por u bë një avari e kalldajës, të cilën e kemi zgjidhë në mbrëmje, nuk kanë shkuë as pesë orë dhe e kemi zgjidhë problemin. Kështu që, çdo propagandë që bëhet për mungesën e druve nëpër shkolla, nuk është e vërtetë. Është e vërtetë që kemi marrë dru prej një shkolle dhe kemi çue në një tjetër. Shkollat i menaxhon DKA-ja, edhe nëse ndonjë shkollë ka mungesë të druve, i marrim prej një shkolle e i çojmë në shkollën tjetër. Po megjithatë, asnjë ditë procesi mësimor nuk është ndalë për shka të mungesës së druve, dhe nuk është e vërtetë që janë mërdhi fëmijët. Nuk janë mërdhi fëmijët për shkak të mungesës së druve. Nëse ka pas diçka tjetër, unë nuk e di, por këtë informatë e dëgjova sot për herë të parë. Sa u përket ankesave të fshatit Zgatar dhe Blaç për pagesën e ndriçimit publik, ne si Komunë nuk mundemi krejt sendet me i bo për një vit. Ne kemi filluar me i bo gradualisht. Vitin e kaluar i kemi shti disa fshatra, këtë vit i kemi përfshi të gjitha fshatrat që kanë ndriçim publik me orë. Vitin e ardhshëm do t'i futim edhe këto fshatra tjera të cilat e kanë ndriçimin publik të lidhur nëpër shtëpi. Sepse për me e lidhë me orë ndriçimin publik duhet tender. Mjete të parapara nuk kemi pas, por do ta shohim, deri në fund të vitit ka mundësi, nëse gjejmë mjete, edhe këto dy fshatra, Zgatar dhe Blaç, do të gjejmë zgjidhjen dhe do t'i lidhim. Përndryshe, për vitin e ardhshëm ju garantoj që të dyve këtyre fshatrave do t'ua zgjidhim problemin, edhe atyre do t'ua paguajmë shpenzimet e ndriçimit publik me mjete të qytetarëve, sepse kemi mjete të mjaftueshme, për Shërbime Publike kemi ndarë diku afër 500 mijë euro. Kështu që kemi mjete, nuk është problemi tek mjetet. Mund të thotë dikush ku po i gjeni këto mjete. Nuk na i ka lëshue Qeveria, këto mjete i kemi ndarë nga kursimet që po i bëjmë. Edhe transportin e nxënësve jemi duke e bërë nga mjetet e kursyera. Unë si kryetar i Komunës, në zyrën time, qe tri vite e gjysmë hala asnjë orendi nuk e kam blerë. Po ashtu edhe në zyrat tjera, nuk kemi blerë edhe kompjutera, nuk kemi blerë edhe orendi. Kështu që, me mjetet që po i kursejmë, po u ndihmojmë qytetarëve me ua lehtësuar jetën e tyre. Uran Halimi pyet se cilët zyrtarë i keni dërguar për me marrë trajnim për prokurim. Komuna e Dragashit ka mungesë të personave të trajnuar dhe të licencuar për punë në Zyrën e Prokurimit, i kemi çue tre personal, e bën kërkesën zyrtare, t'i jap emrat me shkrim. Unë të thashë kështu, ti nëse nuk je i kënaqur, ma bën kërkesën me shkrim edhe t'i jap emrat. Sa i përket stadiumit të fshatit Blaç, drenazha edhe rrethoja, është e vërtetë. Në projektin që e kemi bërë tash, është

përfshirë edhe rregullimi i drenazhës, edhe rrethojat për shkak të punimeve të dobëta që janë bo. Të gjitha projektet e Blaçit të cilat janë paraparë me u investue këtë vit, do të dalin në tender deri në fund të këtij muaji. Sot bile një ka dalë edhe ditët e ardhshme do të dalin edhe dy-tre tenderët tjerë. Sa u përket ujëmbledhësve, e di që ke bo shumë zhurmë për ujëmbledhësat që dy vite. Unë po them dy vite, nuk janë katër, se hala katër vjet unë s'i kam bo, as ti katër vjet nuk i ke që je bo. Unë nuk mund t'i akuzoj ata të kalumit, se ky hala nuk i ka katër vjet që është asambleist. Për ujëmbledhësat e kemi qit ne tenderin, jo qeveria e kaluar. Unë në vitin e parë të qeverisjes i kam zbatue projektet që i ka miratue qeveria e kaluar. Domethënë, një vit veç ka shkue. Këtë problemin e ujëmbledhësve dikush e ka çue në prokurori, edhe na ka ardhë përgjigjja. Pretendimet e personit që i ka çue ujëmbledhësat në prokurori, nuk kanë gjet kurrfarë elementi të keqpërdorimit apo vjedhjes. Kështu që, fli rahat në këtë drejtim, se nuk ka pasur keqpërdorime, as vjedhje, as hajni te tenderët e ujëmbledhësve. Edhe për blerjen e traktorit, traktorët janë pasuri e Komunës. Human Care e bën vetëm pagesën e pagave të traktoristëve dhe të personave që punojnë në QKMF, këtyre mjekëve si gjinekologu etj., gjithashtu e bën pagesën e disa personave që janë të punësuar si teknikë medicinalë. Për trajnimin në kurrikulë, Zenia le ta shpjegojë në mbledhjen e ardhshme. Driton, me sa e di, unë ta dhashë një shpjegim për drejtorët, për konkursin. Nëse nuk është ashtu, Zenia munden me dalë me dhënë përgjigje, po unë e di sigurt që është qashtu qysh të kam thënë unë. Ndoshta nuk ke mujt në uebfaqe Rregulloren, por Ademi e ka, ai e ka përgatit atë Propozim-vendimin, ka qenë te unë dy herë në konsultim, e kemi parë Rregulloren bashkë. Është për një konkurs. Tash munden edhe me u kthye prapë, unë nuk muj me e ditë atë, po unë e di që ky Propozim-vendim është përgatit në bazë të Rregullores. Edhe ti shumë zhurmë po bëjsh për drutë, po shkolla e Bresanës ka pas edhe ka dru për këtë vit sa të duash. Për demolimin e shkollës së vjetër, unë e di që ty nuk të pëlqen – çdo investim që bëhet në Bresanë, ty të dhemb koka – po s'kam faj unë pse të dhemb koka ty, është faji te ti, se e ke një xhelozë patologjike, sepse për shkak të ngarkesës së madhe politike që e ke, ti nuk duash në Bresanë me u bo kurgjo. Ata paraardhësit tu kurgjo nuk kanë bo, e tash na pse po punojmë, ty s'po të pëlqen. Por, ajo është çëshjte e jotja. Demolimin e shkollës, ne me projekt këtë vit – e kemi projektin, shkruan demolimi i shkollës fillore, ndërtimi i parkut të lojërave për fëmijë, janë edhe disa punime tjera që kanë me u bo. Edhe karrikat, edhe bankat e reja, drejtori i shkollës i ka marrë me punëtorët e vet edhe i ka çue në shkollë të re. Ato që nuk vyjnë, karrikat e këqija të cilat janë të thyera, të prishura, ato munden me i marrë kushdo, nëse do, mundesh edhe ti me shkue me i marrë, nëse të pëlqejnë. Edhe, unë ju kam

thënë punëtorëve fizikë të shkollave që gradualisht me e bo demolimin e asaj shkolle, në mënyrë që kur ta hapim tenderin, të na kushtojë pak më lirë. Dikush ka me e demolue tash edhe kulmin, dikush ka me demolue edhe brenda. Kështu që, ne presim që në muajin maj të fillojmë me demolimin e asaj shkolle. E kemi bërë edhe projektin, edhe do të bëhet zgjerimi i hapësirës në atë pjesë. Ajo pjesë do të shërbejë më shumë edhe për pazarin ditën e shtunë, por edhe si parking për ditët tjera për fshatin Bresanë. Faleminderit!

Uran Halimi: Po thotë kryetari, me e pas ditë që dalin për replikë, s'jau përmendi emrin. Po tash përgjigjet ti që m'i japish, janë kappa si me spec, ndonjëherë thuesh unë nuk e di, ndonjëherë ashtu, ndonjëherë kështu. Nuk është që s'ke dhënë përgjigje, por ndonjëherë bëjsh kurse nuk dish. Unë ta kallxoj që e dish. Duhet me iu kallxue qytetarëve që e dish ti përgjigjen, po thuesh para tyre që s'e dish, e lujsh kingjin. Traktorët që i përmende, janë asetë të Komunës, kryetar, që nuk ka të drejtë asnjë kompani private me i shfrytëzue ata. Asetet e Komunës s'ka shancë me i përdorë. Jo, ju nuk i menaxhoni, po i menaxhon Human Care. Po edhe traktorët. Tash, thaje Human Care i bën pagesat. Ne e dimë që i bën pagesat. Kam hulumtue, edhe atëherë kam thënë, disa lajme qëndrojnë në internet që është akuzue si OJQ që ka pas keqpërdorim. Nëse duesh, veç kërko në Google, edhe ta qet që Human Care ka keqpërdorim në Komunën e Mamushës edhe në Komunën e Prishtinës. Ka pas keqpërdorim, janë lajme, publike janë ato. Tash, katër vjet ka 200 mijë euro bëjnë 800 mijë euro, gati 1 milion euro. Në rregull, sado qofshin. Tash, a ekziston një raport financiar i kësaj organizate, a bjer raport financiar në Komunë? Nëse po, a mundesh me e publikue atë raportin financiar në media, ose në uebfaqe të Komunës, me e pa kah i ka shfrytëzue, çka është pague me qato pare prej Human Care. Unë të paktën, kryetar, s'kam mund me e gjet as në emër të kujt është e regjistruar kjo OJQ. Me kënd lidhish marrëveshje kur aplikon? A mundesh një fletëaplikacion me na bo publik neve qytetarëve, me e pa kah po shkojnë përmi 500 mijë euro, ta zëmë, nëse s'janë 800 mijë, mbi 500 mijë janë. Po sa janë, atëherë? Vitin e parë i ke pas 186 mijë euro, në vitin e dytë 200 e diçka mijë euro, të tretin prapë 200 e diçka mijë euro. I bjer që 600 mijë janë, për afërsisht. Sidoqoftë, mbi 500 mijë janë. Me na kallxue qytetarëve ku janë duke shkue qato 500-600 mijë eurot. Ne po besojmë që paguhen punëtorë. Kush po paguhet, sa po paguhet, sa shofera janë, sa traktora janë. S'e di unë sa traktora janë. Është mirë me qenë pak më i hapur për qytetarët. Tash nuk po due me hy thellë, kryetar, e me ta përmend atë kamerën, se s'po kam qef mo me u bo bajat. Ama është mirë me kallxue që ti, kryetar, e dish shum qartë se kush është duke u trajnuar si

zyrtar në Zyrën e Prokurimit. Pse po thuesh s'e di, ose pse po e fshehish para qytetarëve? Bëje publike!

Arijeta Skeraj: Uran, e ke krye replikën! Atëherë, Dritoni e ka fjalën.

Driton Ademi: Kryetar, po duhet me ta përmend diçka publikisht. Kur e ke marrë mandatin, të gjithë të kemi urue edhe kemi qenë te Shpia e Kulturës, shumë mirë e dish, edhe Samidini ka qenë, bashkë kemi qenë, edhe kemi qenë pro demolimit e krejt qetyne pjesëve që janë të vjetra. Mos thuj që s'kemi qenë, kemi qenë pro. Unë kam qenë pro, bile i kam thënë me shkue edhe në kufi, deri ku i takon në Kadastër. Nëse e mbajsh në mend, kanë qenë personat aty. Edhe, nuk mundesh me ma mohue që je kundër investimeve. Unë jam për investime të mira. Ama, nuk u përgjigje ku kanë shkue ato, pagesa kujt iu bë e qatyne hekrave. A ka marrë dikush pare për qato të karrikave dhe bankave, mu qekjo po më intereson, e para. Nuk m'u përgjigje te pjesa e kanalizimit. Po më vjen shumë mirë që është edhe kryetari i fshatit këtu, edhe e kemi diskutue. Kanalizimin te Rruga e Dëshmorëve, prej las Met deri ta Xim. Kryetar, e kemi diskutue na edhe privatisht, e dimë çfarë problemi ajo ka. Nuk është krejt sa thuhet ajo aty, am aka një pjesë që do renovim të ri me bo. Nëse po thuesh ka mjete prej mallrave dhe shërbimeve, a mundesh me ardhë, me e pru një ekspert të Komunës që e kie, edhe me kqyr me e bo. Nuk është puna që është duke të dhënë zor, se ti e dish kanalizimet që janë. Nuk është ndonjë gjatësi shumë e madhe për me investue. Besoj që me dalë veç me e shikue, është një gjatësi shumë e vogël, për një investim të ri. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Vetëm doja të sqaroj disa gjëra. Automjetet nuk janë blerë në pushtetin e kaluar, por gjatë këtij mandati. Unë kam marrë informacion nga raporti i drejtorit tuaj. Sa i përket "Human Care", nuk më dhatë përgjigje nëse jeni të gatshëm të formojmë një komision apo të na dorëzoni të gjithë dokumentacionin për atë që kanë bërë gjatë këtyre katër viteve. Si delegatë kemi të drejtë të dimë çfarë bën Human Care, kush janë ata, personeli i tyre. Duam t'i shohim aplikacionet, kontratat që keni lidhur me ta. Duam të kemi në kuvend dokumentacionin se ku ka shkuar paraja. Qoftë edhe 1 euro – duhet të dihet ku ka përfunduar. Këto harta nuk dua t'i komentoj – është e qartë për mua dhe për popullin.

Munir Jonuzi: Z. Kryetar, mendoj se nuk më keni kuptuar si duhet. Kam menduar që t'i detyroni IT punëtorët tuaj që të shtojnë kategorinë për gjuhën boshnjake. Sepse aty figurojnë vetëm shqip, serbisht dhe anglisht. Është detyra juaj që të ndikoni te punonjësit që të respektojnë këtë gjë. Edhe komuna e Prizrenit është përballur me të njëjtin problem. Ata e kanë zgjidhur atë për dy ditë. Duke qenë se jam profesionist në këtë fushë, e di që ky problem zgjidhet për dy orë. Zyrtarët tuaj nga

prokurimi publik nuk i publikojnë tenderët në faqe. Për transparencë ata duhet t'i publikojnë ato tenderë. Do të aplikoni përsëri për Grantin e Performancës – nëse nuk keni asnjë tender të publikuar, do të merrni pikë negative.

Shpetim Hajredini: Kryetar, më dha përgjigje, edhe pse përgjigjen e kam prit unë prej drejtorit, po ti më dha përgjigje, që thashë fëmijët janë mardhi. Kryetar, fëmijët kanë pas ftohtë në shkolla, të fshatit Kuk thashë, janë mardhi, të thashë shqip. Edhe e di unë, natyrisht që ti nuk mujsh me e ditë, se ti nuk ke fëmijë në shkollë të Kukit, unë i kam fëmijët aty. Por, problemi është që unë shumë bre jam i urtë, edhe nuk due me i marrë çështjet me i bo shumë të mëdha, për hir të respektit të madh që e kam ndaj njërit që e ke ti në ekzekutiv. Përndryshe, unë këto atë ditë i kisha marrë edhe kisha shkue në shkollë, ta kisha çue me temperaturë, me fëmijët me i pa në klasë t'u i çue me xhupa të veshur kështu, edhe ti ahtëherë kishe besue, se s'ke pas arsye, s'ke pas argument mu më m'thënë mo këtu jo, s'janë mardhi, se unë s'e kam marrë atë informacion. Ti s'mujsh me marrë informacion, unë e marr, se unë jam qaty. A ta kam bo deri sot, tri vjet e gjysmë, kurrë s'të kam thënë kurgjo. Ajo qëndron edhe s'ka kush që e kthen mbrapa. Le të dalë njëri, le të më thotë jo, s'është e vërtetë. Thashë, dy javë deri në tri, janë mardhi fëmijët, ka ardhë fëmija im gjithmonë i mardhitë. Të thashë unë, s'kam qef me e bot ë madhe, nuk e kisha bo as tash prapë. Arsyen nuk po e di për çka ka ndodhë ajo, a ka pas naj problem teknik tjetër, për shembull, që s'ka funksionue nxemja, a është problemi i druve që nuk kanë qenë, të thashë që atë nuk e di. Por, kanë ardhë fëmijët të mardhimë. Tjetra që deshta me e lidhë, është pagesa e ndriçimit publik, kryetar. Atë unë ta kam bërë tri vite radhazi, gjithmonë ta kam parashtrua pyetje, po të kam thënë që vitin e fundit mo pyetje nuk bëj. Edhe shtatorin e ke pas fundin, se të kam thënë që e qes, vetëm dora e asambleistëve e kryen punën. Po ti e kreve para asaj, në rregull është, krejt okej jemi te kjo. Por, për këto dy fshatra e di që mujsh me e bo. Thaje e bëj në vitin 2026, po në 2026-tën a jemi gjallë a s'jemi gjallë, a je ti kryetar a s'je. Po ne mujm me e parapa, po e di që ke mundësi financiare me jau krye edhe ma shpejt. Megjithatë, kjo mbetet në ndërgjegjen edhe në atë çështjen tënde, se nëse mujsh me jau krye apo jo. Çështja tjetër – edhe pse nuk deshta më me i hy kësaj teme – Ferokromi. Ti thaje që e kemi ndërprerë. Ju nuk është dashtë me na çue fare këtë pikë të rendit të ditës, kur e keni ditë që është e rrezikshme. Ju na keni pru, kur e paje që ata veç po intervenojnë keq, qytetarët, e prut edhe ne ta mbështetëm. Të mbështesim na prapë, të kam thënë, sa herë të jetë në të mirën e qytetarëve, ne kemi me të mbështet deri në fund. Faleminderit!

Qamil Kolloni: Kryetar, edhe për ju delegatë, veç mos të spekulohet, se po spekulohet këtu në vazhdimësi. Nuk vlen kjo veç për Nedžmidinin edhe Munirin, është në përgjithësi për delegatët. Unë po mundohem me ia shpjegue se qe ky Ujësjiellësi i është nënshtruar debatit publik që në vitin 2010. Dhe, pasi i ka kaluar të gjitha fazat e dëgjimit publik dhe kontakteve me qytetarët në 2010-tën, në 2012-tën ka ardhë në Kuvend dhe është miratuar si projekt. Përpo që është miratuar si projekt, ka pas 2 milionë e 700 mijë euro grant jashtë buxhetit komunal për investim në projektin e Ujësjiellësit – Dragash. Dhe, po të njëjtin projekt ne e kemi gjet dhe jemi duke e zhvilluar. Kryetari i ka krye të gjitha procedurat. Nuk mundemi në secilën seancë, pse Nexha do me spekulue edhe me shti ndai ndërmjet komunitetit goran edhe këtij shqiptar për investimin më të madh kapital që ndonjëherë ka pas Komuna e Dragashit. Kjo vlen edhe për delegatët shqiptarë, edhe për delegatët goranë, që duhe të përfundojnë këto spekulime, sepse mënyra qysh ky po mundohet me e paraqit problemin e Ujësjiellësit, është përçarëse. Dhe nuk munden kryetari me i ndejt këtij roje, në secilën seancë me i dhënë dëshmi sa herë t’i teket këtij me manipulue veç pse janë kamerat këtu, me manipulue me projektin e ujit. Projekti i ujit ka me u krye edhe sivjet lëshohet. Prandaj të lutem, Nedžmidin, këto janë faktet dhe faktet nuk janë kërcënim. Në qoftë se të duken ty faktet kërcënim, e di pse të duken. Të kërcënojnë ty, se nuk e lënë vullnetin tënd me e çue në fund, me na përça neve. Ne kemi me e realizue këtë projekt. Sa i përket çështjes së Human Care, ju e dini, edhe kolegu e di shumë mirë, se kanë qenë kontratat mbi vepër. Me ligjin e ri janë ndërprerë dhe kontratat për shërbime kryhen përmes organizatave të specializuara. Dhe, për me i hek kontratat të cilat i kemi pas në auditim, dhe për atë arsye qeverisja e mëhershme e ka humb Grantin e Performancës, kanë qenë kontratat njëburimore. Këto kontrata i kemi ndërprerë dhe i kemi bërë kontratat e shërbimeve. Çka është më interesant, vitin e kaluar ka qenë pjesë e auditimit kontrata e Human Care, dhe auditorët na kanë kualifikue pozitivisht dhe ne kemi marrë Grantin. Ju e dini që e kemi fitue Grantin. Me u pas vlerësue si negative qajo kontratë e Human Care, nuk nuk do ta kishim Grantin e Performancës. Tash, unë nuk e di a ka organ më të mirë që e bën verifikimin, sesa ju që po mundohnu të bini spekulime, si Urani, me e bo spekulimin, sepse ka inate personale me ndonjë punëtor këtu, edhe me ik. Nuk bën me e gjujt gurin, burra, edhe me e fsheh dorën. Në qoftë se duam sinqerisht me diskutue, po i shtrojmë problemet sinqerisht. Dhe ky është sinqeriteti, të lutem! Qe ku të shkruan viti 2010. Për 22 mijë e 300 banorë është planifikuar qe ky Ujësjiellës. Deri në vitin 2040 përmbushen nevojat e qytetarëve. Për 15 fshatra. Nuk çohen me folë delegatët që janë të atyre fshatarve edhe pritët me e pi ujin, edhe të lënë ty me spekulue këtu. Të gjitha të

dhënat i ke këtu, në qoftë se duash, vijsh e marrish edhe procesin. Vijsh e marrish edhe procesin e diskutimeve në Radeshë, vijsh e marrish edhe projektin detal. Kurgjo nuk kemi ndryshue prej atij projekti detal që është vulos nga qekey Kuvend, nga këta delegatë, nga qeverisja e kaluar. E vetmja çka ka mbet e mirë prej atëherë, deri më tash, janë pikërisht këto dokumentacione. Dhe ai projekt, për këto dokumentacione, sot e kësaj dite vazhdon, dhe nuk mundesh ti sa herë të teket me dalë, me na qit kryetarin tonë qysh të teket ty, Nedžmidin Sejdilar. Në qoftë se ai është tolerant, boll më, mos e keqpërdor tolerancën e tij. Të lutem, boll!

Nedžmidin Sejdilar: Ka një thënie të vjetër që thotë: “Nuk më vjen keq që je kumarxhi, por që do vish të justifikohesh.” Kolloni e vendosi një hartë këtu dhe mua nuk më është e qartë se si ai mund të shpjegojë nga ajo pozitë. Nuk do ta kisha problem nëse ai do ta merrte hartën me vete kur të fliste nga foltorja. Pasi unë përfundova diskutimin për lumin e Radeshit, ai në mënyrë energjike – ndoshta edhe agresive – e ngjiti hartën pranë foltores. Mënyra se si e bëri këtë, për mua ishte kërcënim. Katër vjet mund të pyes të njëjtën gjë. Kërkoj që kryetari ta publikojë dokumentin nga viti 2016. Të sjellë kundër-peticionin në kuvend. Nuk po kërkoj asgjë që është jashtëligjshme. Harta është një mashtrim.

Munir Jonuzi: Z. Drejtor, ju jeni një dribler i mirë, manipulues i shkëlqyer, dhe edhe më se miri e shtrembëroni fjalën time. Unë kam folur këtu për një veprim që nuk i ka hije një drejtori të komunës. Nuk mund të jem ulur – apo kushdo tjetër të jetë në foltore – dhe ju të më afroheni në fytyrë dhe të vendosni ndonjë hartë. Unë asnjëherë nuk përmenda projektin e ujësjellësit. Fola për sjelljen tuaj. A e dini çfarë ndodhi në Kuvendin e Kosovës kur një deputet iu afrua kryeministrit? Ndodhi kaos në kuvend. Këtë po e nxisni ju me sjelljet tuaja. Ky veprim nuk dallon aspak nga ai rast – nëse e kujtoni. Kam folur për sjelljet tuaja, jo për projektet tuaja. Ky është veprim i papërshtatshëm, jo vetëm për një drejtor, por për çdokënd. Kur ne jemi në foltore, duhet të na respektoni. Shpjegoni vetëm kur merrni fjalën.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë, kjo pikë eventuale u kërkua shumë nga asambleistët. U akuzua kryetari që nuk jem përgjigje. E kisha lut Radio Sharrin që me e kqyr a është Asambleja apo kryetari, ai që është duke ndejt deri në tash, në këto momente. Edhe pse nuk ka pas kuorum, unë e kam lut kryetarin që me dhënë përgjigje. E kisha lut Radio Sharrin, Tv Opojën – asnjë asambleist nuk gjendet, përveç tre a katër vetë. Kjo a më jep mu arsye me e qit pikën eventuale në rendin e ditës në seancën tjerër, i vihet një pikëpyetje. Kjo është e rëndë për të gjithë asambleistët që janë të votuar të popullit. Unë si asambleiste 19-vjeçare, asnjëherë nuk e kam lëshue – këtu

është Samidini. Si mundem unë me iu përgjigj Artan Loshajt që më ka bo pyetje, kur nuk rri me marrë përgjigje. Kryetari është pak më transparent edhe i ka dhënë përgjigje, unë nuk do t'ia jap përgjigjen, përderia nuk është asambleisti. Gjithmonë unë po folem për të keq, po shikone se pothuajse asnjë asambleist – dy të PDK-së janë, dy të LDK-së, i VAKAT-it edhe i Pogret za Gora. Tjerit kanë dalë. Atëherë, kjo më jep me kuptue që pika eventuale nuk besoj që do të qitet në muajin tjetër si pikë e rendit të ditës. Faleminderit të gjithëve! E mbyllim këtë seancë!

Kryesuesja e Kuvendit

Arijeta Skeraj